



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
17 PRILL 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
17. APRILA 2008. GODINE

Prill – April
2008

R e n d i i d i t ë s:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë Projektligjit për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sporte,
4. Shqyrtimi parë i Projektligjit për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera,
5. Shqyrtimi parë i Projektligjit për ndërmjetësim, dhe
6. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të SLS-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Punë Jashtme.

D n e v n i r e d:

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sponzorstvu u kulturi, omladini i sportu,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Nacionalnom ansamblu pesama i igara „Šota“ i drugim ansamblima,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o posredovanju, i
6. Razmatranje predloga Parlamentarne Grupe SLS za zamenu člana Komisije za spoljne poslove.

A g e n d a:

1. Approval of the minutes from the previous session,
2. Time for Parliamentary questions,
3. First reading of the Draft Law on the Sponsorships in Culture, Youth and Sports,
4. First reading of the Draft Law on National Song and Dance Ensemble “Shota”
5. and other Ensembles,
6. First reading of the Draft Law on Mediation,
7. Review of SLS Parliamentary Group proposal for replacement of a member of Committee on Foreign Affairs.

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 17 PRILL 2008

Seanca filloi punën në orën 10,00

Seancën e drejtoi zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, të nderuar zëvendëskrye-ministra, të nderuar ministra, mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë 97 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për ta filluar punën.

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 6 pika 2 dhe 23 të Rregullorës së Punës të Kryesisë së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Rendi i ditës, së bashku me materialin, iu është shpërndarë deputetëve me kohë.

Prandaj, po fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Numan, për çfarë e kërkon fjalën? Nëse e ke për rend të ditës, kur të shkojmë në atë pikë, mund ta marrësh fjalën.

Urdhëroni! Fjalën e ka deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Zoti Kryetar, unë propozoj që në Kuvend të futet edhe një pikë e rendit të ditës – nxjerrja e një deklarate kundër akuzave të Carla del Ponte, që e ka bërë ndaj UÇK-së dhe të inicohet një aktakuzë për ish-prokuroren.

KRYETARI: E ka fjalën deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar! Po ashtu lidhur me rendin e ditës, unë ju kisha ftuar juve si Kryetar i Parlamentit dhe grupet parlamentare që të shqyrtoni mundësinë që brenda kësaj seance, apo në ditën e nesërme, të trajtohet përmes një konsensusi këtu një rezolutë lidhur me paralajmërimet se në Kosovë do të mbahen zgjedhjet e një vendi fqinj.

Mendoj se është emergjente dhe e kohës që ky Parlament ta thotë fjalën dhe zërin e vet si institucion, në mënyrë që të mos kemi cenim të sovranitetit dhe integritetit të vendit tonë. Qeveria dhe UNMIK-u të veprojnë në pajtim me detyrimet dhe mandatet që u takojnë.

Kujtoj se është mirë që kjo pastaj t'i dërgohet UNMIK-ut, i cili ka për detyrë që, në fund të këtij mandati, të mos na provokojë me një situatë të re, sepse ajo do të prodhojë pasoja shumë të rënda për vendin dhe mendoj se është e rendit që brenda ditës së sotme të trajtohet kjo çështje. Pra, i takon këtij institucioni që ta thotë fjalën e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Temat janë të qëlluara, por nuk janë që duhet të trajtohen sot dhe me urgjencë. Prandaj le të ndiqet procedura e rendit të ditës dhe të bëhet kërkesë me shkrim nga grup deputetësh ose grupet parlamentare të deputetëve.

Për fjalë është lajmëruar deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Dëshiroj të tërheq vëmendjen se nuk janë përmbushur rregullat për mbajtjen e seancës dhe ju, si Kryetar i Kuvendit, keni përgjegjësinë që t'u përmbaheni rregullave.

Thirrrem në Rregullën 6.3, sipas së cilës Kryesia takohet së paku një javë para seancës. Ju jeni takuar, zoti Kryetar, të martën, më 15 prill, e sot është 17 prill.

E dyta, ftesat dhe rendi i ditës, po ashtu sipas Rregullës 6.3, bëhen së paku 3 ditë para seancës. Materiali ka ardhur, po ashtu, një pjesë të martën, një pjesë të mërkurës, që do të thotë se është shkelur Rregulla 6.3.

Meqenëse nuk ka dispozitë të veçantë, me të cilën mund të shprehë deputeti pakënaqësinë ndaj Kryetarit të Kuvendit, pasi që supozohet se Kryetari i Kuvendit është ai i cili i pari i përmbushë rregullat, zoti Kryetar, ju ftoj që të keni kujdes, prandaj edhe për debatin e nesërm, duhet ta dini, nuk i keni plotësuar kushtet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj se seanca e sotme është caktuar më 8 prill dhe janë plotësuar të gjitha kushtet.

Ju si Grup Parlamentar, në Kryesinë e Parlamentit, e keni anëtarin e Kryesisë dhe e keni edhe shefin e Grupit Parlamentar, prandaj mendoj se përmes tyre duhet t'i ngrehni çështjet. Fjalën e ka Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I dakorduar me shqetësimin, të cilin e ngriti edhe deputeti Rexhepi, si Grup Parlamentar kërkojmë që kjo seancë plenare të artikulojë një qëndrim i cili kundërshton tendencat e qeverisë së Beogradit për të mbajtur zgjedhje në Kosovë.

Prandaj, kjo seancë plenare, nuk guxon të qëndrojë karshi apo anash zhvillimeve të cilat ndodhin dhe për këtë drejtpërdrejt i cenon interesat dhe integritetin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Lexojeni Rregulloren dhe pikën 23 pika 2 dhe ushtroni kërkesë me shkrim për të shtuar rendin e ditës. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht e mbështes propozimin e deputetit Rexhepi. Mendoj se është me vend dhe nëse edhe sot nuk mund ta fusim këtë në seancë, atëherë duhet të diskutojmë që ta kemi të qartë se kur do të ndodh kjo.

Edhe seanca plenare ka të drejtë që të diskutojë për agjendën dhe çështja tjetër është se Kryesia e Kuvendit me shefat e grupeve parlamentare është takuar të martën, sot është e enjte. Është e vërtetë që është takuar dhe është e vërtetë që kemi qenë aty, por të martën është takuar Kryesia, të martën janë marrë vendimet. Sot është dita e enjte! Nuk qëndron ajo që iu përgjigjët deputetes Sylja. Faleminderit!

KRYETARI: Datën 15 prill, Kryesia, këtë seancë ka caktuar me datën 8 prill, prandaj ju lus mos i shtrembëroni gjërat. Do të thotë, kjo seancë e sodit, është caktuar më 8 prill. Këtë ta keni të qartë. Edhe për të nesërmen, flasim nesër. Sot, po flasim për sot. E ka fjalën Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Zoti Kryetar,

Me lejen tuaj, më lejoni ta jap një sqarim rreth inicimit që ndodhi për një deklaram apo një qëndrim lidhur me 11 majin.

Konform qëndrimit të Qeverisë, ne kemi iniciuar sot si Grup Parlamentar i LDK fillimin e konsultimeve në mes shefave të grupeve parlamentare. Besojmë se gjatë ditës do të harmonizojmë qëndrimet dhe do të vijmë para jush dhe Kryesisë me qëndrim të përbashkët në mënyrë që ky Kuvend të deklarohet.

Duke dashur të ndihmojmë që të mos bëhet temë tash individuale e deputetëve, ne kemi filluar në mëngjes me inicim të Grupit Parlamentar dhe do të dalim me qëndrim zyrtar dhe do të kemi qëndrim të përbashkët.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e kam vetëm një vërejtje, sepse Parlamenti i Kosovës nuk është “kopsht kalamajsh”.

Ne i kemi aprovuar simbolet kombëtare dhe Kuvendit të Kosovës i mungon flamuri i Republikës. Tani e tutje, besoj se do të jemi në Parlament, do t’i kemi simbolet tona që përcaktojnë se kush jemi ne dhe vërtet jemi në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është mirë të rezervoheni për kualifikime! Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë, ministra të nderuar,

Unë vetëm desha të bëj një sqarim lidhur me pohimet e një diskutuesi paraprak lidhur me materialet e marra për këtë seancë. Materialet janë marrë më 31 mars, domethënë me 31 mars, jo pardje apo dje, si po thuhet. Prandaj, duhet të jemi korrekt në raport edhe me opinionin publik, jo vetëm në raport me deputetët këtu.

KRYETARI: Fjalën e ka Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë kërkoj falje që, në fillim ndoshta do të ulë pak nivelin e propozimeve rreth rendit të ditës në këtë Kuvend, por më tepër jam i prirë që të nisem nga ajo që quhet praktike.

Ne para do kohësh kemi pasur një raport dhe rekomandim të Komisionit për buxhet dhe financa për shqyrtim të raportit të organit rregullativ të prokurimit publik, i cili natyrisht ka mbetur që me një sugjerim apo qëndrim edhe të Qeverisë do të duhej edhe në Qeveri të shqyrtohet kjo çështje, të cilin nuk e kemi deri sot dhe kemi menduar që do të duhej të ishte kjo pikë e rendit të ditës.

Dhe, e dyta. Pikërisht po ky Komision ka kërkuar që në kuadër të kësaj të dalë Kryesia e Kuvendit dhe Kuvendi me propozimin dhe qëndrimin për zgjedhjen e organit shqyrtues të prokurimit publik, i cili është më se i nevojshëm dhe është një e drejtë ligjore që duhet plotësuar.

Dhe, një çështje e tretë, po ashtu, aq e rëndësishme është se, ju e dini që më 31 mars i ka kaluar mandati Këshillit të Agjencionit Antikorrupcion dhe ky Kuvend është dashur të dalë me propozime. Ne si Komision i kemi dhënë disa propozime tona të cilat nuk di se a i ka shqyrtuar Kryesia.

Prandaj, mendoj se këto janë çështje të ngutshme dhe duhet të futen në rendin e ditës. Dhe, vërtet për propozimet lidhur me: “zgjedhjet e Serbisë” dhe çështjet tjera, mendoj se ato zgjedhje të Serbisë nuk janë proklamuar dje, as sot në mëngjes, por ka do kohë, prandaj është dashur pak më herët ndoshta të mendohet dhe të procedohet në forma tjera që do t’i duhej Kuvendit të merret me ato çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën deputetja Donika Kada.

DONIKA KADA: Kryetar, rregulla thotë dhe përcakton që të gjitha diskutimet rreth rendit të ditës të zgjasin një minutë, prandaj ju lutem prapë, përmbajuni Rregullores dhe mos iu jepni hapësirë njerëzve për pesë minuta të propagandojnë.

KRYETARI: Regjia do ta ketë parasysh këtë që thatë.

Mendoj se nuk ka paraqitje tjera për diskutim.

Vazhdojmë më tej.

**- Miratimi i procesverbaleve nga seancat plenare të mbajtura më
4 dhe 9 prill 2008**

Ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 4 dhe 9 prill 2008 iu janë shpërndarë deputetëve.

Para se t’ua jap fjalën, do të jap një sqarim për seancën e 9 prillit 2008.

Do të thotë, unë kam qenë duke e udhëhequr seancën. Deputetët janë ngritur në këmbë. Ndoshta nuk i kam parë unë të gjithë deputetët që nuk janë ngritur dhe kam konstatuar se me aklamacion 107 deputetë kanë votuar “për”. Në ndërkohë, nëse keni vërejtur, në faqen e Kuvendit, ne kemi thënë se 4 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim.

Kur është fjala për seancën më 9 prill, lus deputetët që donë ta deklarojnë votën e tyre “për”, “kundër” ose abstenim dhe ta regjistrojmë në procesverbal, sepse kjo në fund të fundit mund të korrigjohet në procesverbal.

Prandaj, paraprakisht kërkoj nga deputetët të deklarohen për Procesverbalin e seancës së 4 prillit.

A ka ndokush vërejtje në Procesverbalin e seancës, të mbajtur më 4 prill 2008.

Fillimisht jemi te seanca e mbajtur më 4 prill dhe pyes deputetët a kanë vërejtje në Procesverbalin e seancës së 4 prillit. E ka fjalën Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabinet qeveritar,

Zoti Kryetar,

Unë mendoj se edhe kjo është një shkelje shumë e rëndë që po i bëhet Kuvendit dhe një fyerje që po u bëhet deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Duke pasur parasysh Rregulloren e Punës të Kuvendit që asnjë ligj nuk mund të votohet me aklamacion, ju, përveç procedurës së shkurtuar që e keni miratuar Kushtetutën në Kuvendin e Kosovës – një ditë më parë Projektin dhe të nesërmen është aprovuar, e që përmes mediave Komisioni Kushtetues e ka nënshkruar dhe ka thënë se Komisioni Kushtetues e nënshkroi jo draft-kushtetutën por Kushtetutën, ndërsa para nesh e keni sjellë një Kushtetutë të cilën keni kërkuar të aprovohet me aklamacion.

Dhe, zoti Kryetar, keni bërë shkelje të rëndë! Atë ditë është dashur të kërkoni, siç e kërkon Rregullorja e Kuvendit, dhe të thoni: kush është “për” dhe kush është “kundër”.

KRYETARI: Ju lutem, jemi duke debatuar për Procesverbalin e seancës së 4 prillit!

BESA GAXHERRI: Dhe, ju lutem, mos më ndërhyjni, dua ta përfundoj e pastaj mund ta merrni fjalën.

KRYETARI: Po ndërhyj sepse s’jeni në rend të ditës. Është Procesverbali i seancës së 4 prillit dhe ju mësohuni e bëjeni një kulturë të komunikimit.

BESA GAXHERI: Po ne nuk mund të mësohemi të bëjmë kulturë të komunikimit kur ju i shkëlmi rregullat, zoti Kryetar! Ka qenë seanca. Në atë seancë është dashur të pyetni: kush është “për”, kush është “kundër” e jo, pastaj sekretari i Kuvendit të marrë të drejtën e t’i thërrasë deputetët në telefon e t’i pyet – “a ke qenë për a kundër”. Kush është sekretari që ta pyes deputetin? Ju, keni obligim ta pyetni deputetin. Për këtë është Rregullorja. Tash

është shumë vonë të kërkohet kush është “për” e kush është “kundër”. Keni bërë shkelje edhe me vetë Kushtetutën. Na keni fyer si deputetë!

KRYETARI: Unë, edhe një herë, po sqaroj për hir të opinionit, jo për hir të deputetëve që s’duan të marrin vesh shqip.

Unë kam qenë duke udhëhequr seancën. Ju deputetët, shumica e deputetëve, edhe më shumë se 100 deputetë - janë ngritur në këmbë. Unë s’kam mund t’i vërej të gjithë dhe nuk e di a ka më shumë ngritje dore a ngritje në këmbë të deputetëve.

Prandaj, ju lus, sepse jam shumë i qartë. Deputetët që donë ta deklarojnë votën e tyre “për” ose “kundër” për ta përmirësuar procesverbalin ose që abstenojnë, le të deklarohen. Kjo çështje është votuar dhe ka shkuar, prandaj nëse ndokush dëshiron ta deklarojë votën e vet, në mënyrë të kulturuar, le të deklarojë dhe këtë mundësi e ka, e ne pastaj e përmirësojmë procesverbalin, e nëse doni edhe me emrin tuaj.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohet për transkriptim)

Prandaj, ju lutem, kështu qëndron kjo. Fjalën e ka deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ja bih samo hteo da kažem vrlo kratko nešto o sjednici za 9. april, koju ste već spomenuli, da su u pitanju dvije stvari: Vi ste najprije pozvali na izjašnjavanje putem glasanja.

Izjašnjavanje putem glasanja je jasno propisano, da se obavlja izjašnjavanjem „za“, „protiv“ i „uzdržanih“. Nakon toga ste prešli na pozivanje na ustajanje, što bi se moglo protumačiti prihvatanje aklamacijom, a ne glasanjem. Znači, aklamacija nije način glasanja. Aklamacija je prihvatanje odredjenog predloga.

Treće, vi ste rekli da je 107 poslanika glasalo. U stvari, glasanja nije bilo, bilo je ustajanje na noge.

I četvrto, prema našim informacijama, u razgovorima sa sekretarom Skupštine, a on je ovde i može potvrditi, imamo izvore da 9 poslanika nije uzelo učešća ustajanjem, odnosno ovakvim odobravanjem putem aklamacije.

Dakle, tražim da se ispravi zapisnik. Tražim od vas da, kao predsednik Skupštine, date dužno pojašnjenje, valjano pojašnjenje i izvinjenje za prekršaj procedure i da se, naravno, u zapisnik unese tačno koji su podaci vezani za ovo. Hvala vam ljepo!

KRYETARI: Lus regjinë, le ta respektojë kohën. Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë e kam për datën 4 prill një përmirësim të vogël, sipas renditjes.

Në faqen 6, aty ku thuhet se “edhe unë do t’i bashkëngjitem urimit, por edhe keqardhjes për familjen”, gabimisht është shkruar këtu “e Lah Ibrahimajt”, që sa e di unë zotëriu është Lahi Ibrahimaj dhe pastaj, përsëri këtu, bëhet gabimi tjetër dhe thuhet: “Lah Ibrahimaj”. Domethënë, kemi të bëjmë me zotëriun Lahi Ibrahimaj. Desha ta përmirësoni këtë gabim. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Po më duket, u ngatërruan gjërat pak tash dhe s’po dihet a është katërshi tash i procesverbalit apo nëntëshi. Unë do të flas për këtë të dytën, natyrisht, pasi u tollovit krejt dhe ju e lejuat këtë.

Unë mendoj se është shumë e pandershme të kërkohet nga deputetët sot të bëjnë deklarime përmes telefonit. Mua, në telefon më kanë thirrur që të deklarohej për seancën e datës 9, në kohën kur Kryetari i Parlamentit, thjeshtë, nuk e ka qitur në votim ose e ka qitur në votim, por nuk është votuar dokumenti më i rëndësishëm i shtetit të pavarur të Kosovës.

Është fyerje, së pari pse është bërë, qysh është bërë. E dyta fyerje, për deputetin, është ta thirrsh dhe ta pyesësh a keni qenë “kundër”, apo keni abstenuar. Dhe, unë mendoj, kjo është totalisht e papranueshme.

Ajo çka mund të konstatohet, është se: Nuk është bërë votim, është bërë aklamacion dhe deputetë të caktuar nuk janë ngritur në këmbë.

Më falni, por të kërkosh deklarim këtu – a ke qenë “kundër” a abstenim, nuk shkon. Në të gjithë këtë parregullsi, ju po bëni një parregullsi edhe më të madhe. Prandaj, në ato rregullsi, rregulli është që së paku të konstaton që deputetë të caktuar, në dashi qitni emra, në dashi mos i qitni hiq dhe s’ka lidhje kjo – nuk jam ngritur në këmbë, por a je “kundër” a abstenon, ose “për” – kjo nuk vjen në shprehje, sepse këtë nuk e keni bërë.

Prandaj, mendoj, duhet të jeni korrekt me vetveten së pari, dhe korrekt me të gjithë deputetët. Është fyerje jashtëzakonisht e madhe të më marrë dhe të më thërrasë në telefon mua Sekretaria dhe të më pyet a kam qenë “kundër” apo kam abstenuar. Ju lutem shumë, e keni bërë këtë Parlament... ! E bëftë zoti mirë!

KRYETARI: Unë, përsëri, nuk dua t’i sqaroj deputetët. Dua ta sqaroj opinionin. Kryetari i Parlamentit të Kosovës, nuk ka urdhëruar as sekretarin dhe askënd tjetër që t’i pyes deputetët se si do ta deklarojnë votën e tyre. Kjo është nën një.

Nën dy, unë e dhashë sqarimin. Dhe nën tre, nuk ka nevojë të na mbani ligjëratat, por nëse dikush nuk pajtohet me formën e aklamacionit që janë ngritur në këmbë të gjithë deputetët, me ndonjë përjashtim dhe ata që s’janë ngritur le ta deklarojnë votën e tyre se janë “kundër” apo abstenojnë. Kjo kërkohet vetëm për t’u përmirësuar në procesverbal. Nuk kemi kurrfarë qëllimi tjetër.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohej për transkriptim)

Nejse. Kjo është kulturë e jotja. Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti Kryetar, tash po kthehem në pikën 9, sepse pajtohem me zonjushën Tërmkolli që u përziën pikat.

Atë ditë, siç e dimë, nuk ka pasur debat. Është shkelur në integritetin e këtij Parlamenti. Pa dashur të bëhem këtu “më katolik se Papa”, por kjo mënyrë apo ajo mënyrë e të votuarit, unë nuk jam politolog, por aq sa kam njohuri, nuk kam hasur që diku në botë që kështu të votohet kushtetuta, andaj unë e kam refuzuar ngritjen – aklacionin. Ky është sqarimi im. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Respekt zotëri Kryetar, qeveritarë, deputetë, Për hir të momentit në të cilin është miratuar akti politik, juridik, suprem i këtij vendi – i Republikës së Kosovës, unë do të isha angazhuar që në këtë çështje ta absolutojmë, ani pse në aspektin juridik formal janë bërë disa, si të them, shmangie, por nuk janë esenciale, nuk janë substanciale. Dhe, nisur nga fakti se do të votohej në çfarëdo mënyre ky dokument, ndoshta me ndonjë votë kundër, por do të votohej – unë mendoj dhe apeloj që këtë çështje ta absolutojmë, sepse Kushtetuta e Republikës së Kosovës është miratuar dhe tani duhet ta zbatojmë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Fjalën e ka deputeti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: I nderuari, zoti Kryetar!

E kam një pyetje shumë të thjeshtë: Me cilën rregullore të Kuvendit shkruhet që ka votim me ngritje në këmbë, me cilën rregull dhe thjeshtë pyetja është: – a ka votim me ngritje të deputetëve në këmbë?

KRYETARI: Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti Kryetar!

Përsëritje të nderuar zëvendëskryeministra, ministra, të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj që po bisedojmë për një çështje që tanimë është përfundimtare. Çdokund dhe shumë demokratike është mënyra e votimit kur deputetët, ende pa e dhënë mundësinë që kryetari të përcaktohet për mënyrën e votimit, të ngrihen në këmbë dhe të votojnë me aklacion dhe duartrokitje. Edhe kjo është formë demokratike e shprehjes së vullnetit dhe nuk shoh asnjë pengesë këtu, as ligjore, as institucionale. Ajo është forma më demokratike me të cilën mund të shprehen deputetët në parlament.

Është çështje e deklaramit të dy-tre vetave dhe kjo çështje, mendoj, se po deklarohet. Prandaj, nuk është mirë që, për shkak të opinionit dhe për qartësim të opinionit, të

ngrehim çështje të cilat nuk janë sot në rend dite, sepse ne kemi aprovuar në mënyrën më demokratike Kushtetutën e Kosovës duke u ngritur në këmbë e duke duartrokitur dhe kjo është formë demokratike e shprehjes së vullnetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

U bë temë e madhe dhe është pritur që do të bëhet temë e madhe çështja e votimit të Kushtetutës.

Së pari, i keni bërë dy lëshime shumë të mëdha, ndoshta nga mospërvoja apo mosdija, nuk po di ta vlerësoj këtë.

Nuk na e keni dhënë mundësinë që të votojmë për aktin më të lartë juridik të shtetit të Kosovës. Pra, s'na e keni dhënë një mundësi dhe kjo është një formë fyese për ne. Historikisht, nuk do të mund të themi se e kemi ngritur dorën dhe e kemi votuar Kushtetutën e parë të Republikës së Kosovës.

Dhe, së dyti, iu keni dhënë mundësi atyre që janë të interesuar ta kontestojnë këtë dhe të thonë se Kushtetuta, me të cilën ju punoni tash, nuk është votuar në Parlamentin e Kosovës.

Mendoj se nuk është dashur të ndodhë kjo dhe pavarësisht që jemi ngritur në këmbë dhe kemi shprehur emocionet tona për aktin më të lartë, mundësia për të votuar ka qenë, dhe askush nuk ju ka penguar që edhe një herë të kërkonit ta ngrehim dorën për këtë.

Prandaj, duhet ta pranoni se keni bërë lëshim dhe është bërë një lëshim që ndoshta do të mbetet, në njëfarë forme, si njollë historike për historinë e këtij Parlamenti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Adresoj një vërejtje, e cila është mjaft serioze dhe ka të bëjë kryekëput me udhëheqjen e seancës plenare.

Qëndrimet, të cilat merren në takim të përbashkët të Kryetarit të Kuvendit me shefat e grupeve parlamentare, duhet të respektohen. Prandaj, kemi obligim që ato qëndrime, ato marrëveshje që arrihen, t'i implementojmë në seancë plenare.

Seanca e kaluar, kur është miratuar Projekt-Kushtetuta e Kosovës nuk ka qenë, as nuk ka qenë pjesë e diskutimit ajo procedurë në mes të shefave të grupeve parlamentare. Prandaj, një gjë e tillë duhet të theksohet dhe duhet të merret një përgjegjësi pse ndodhin këto gjëra. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Desha edhe një herë të reagoj kundër disa patronizimeve të disa njerëzve këtu.

Nuk ka pasur debat. Nëse e kuptoni këtë, veç jeni kah paragjykoni se do të votohej apo nuk do të votohej. Nga fakti se nuk ka pasur debat nga ky Parlament, jemi sjellë para aktit të kryer. Unë kam refuzuar të sillem si në “Senatin e Kaligullës”. Kaq.

Jam deputet i qytetarëve të Kosovës, andaj kam obligim të debatoj. Kushtetuta apo Projekt-Kushtetuta na është sjellë të nesërmen. Domethënë disa orë para se ta diskutojmë. Nëse Komisioni Kushtetues ka marrë pjesë në debate me OJQ, le të shkojë le t’ua lypë atyre votën, mos t’na e lyp neve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përsëri dua të them një fjalë. Unë kam konsideruar se do të mjaftojë ngritja në këmbë e deputetëve dhe mund të them se shumica ose më tepër se 90% janë ngritur në këmbë. Mund të ketë ndodh që në atë s’i kam parë të gjithë, por ngritja në këmbë e deputetëve ka qenë për mua votim dhe unë s’di përse do të kisha përsëritur këtë.

Dhe tjetra, nëse ka deputetë që nuk donë ta dhënë votën e tyre për atë Kushtetutë, e përmirësojmë procesverbalin, sepse në procesverbal është që unë kam thënë 107 deputetë dhe nëse nuk janë 107, atëherë le ta dimë numrin e atyre që nuk kanë qenë “për” gjatë votimit dhe po e korrigjojmë dhe kjo që mund të bëjmë është ta korrigjojmë procesverbalin. Prandaj edhe kërkoja ta korrigjojmë procesverbalin e jo të merremi tash vërtet me ligjërata, sepse s’ka nevojë për këtë çështje të merremi me ligjërata.

Prandaj, edhe një herë kërkoj: cili deputet, prej 107 deputetëve që kanë qenë pjesëmarrës në seancën e kaluar, nuk do ta jap votën “për” por do të deklarohej ose “kundër” ose abstenon. Kjo është tash e vetmja mundësi të korrigjohet procesverbali dhe unë po kërkoj të korrigjohet procesverbali.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohej për transkriptim)

Jo, një herë nuk ka. Pra, kush nuk do ta ketë votën për Kushtetutën, le të deklarohej ose “kundër” ose abstenim. Ose, nëse doni - a pajtoheni se numri prej 107 deputetë e kanë votuar Kushtetutën.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohej për transkriptim)

Nuk ka propozim, por kush do ta deklarojë votën e vet kundër asaj që e kemi thënë në procesverbal.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohej për transkriptim)

Atëherë, kush është për t'u miratuar procesverbalet e seancave të 4 dhe 9 prillit?
Faleminderit shumë!

Kush është kundër? Sekretaria, le t'i numërojë votat.

Konstatohet se me shumicë absolute, me 3 vota kundër, miratohen procesverbalet e seancave 4 dhe 9 prill 2008.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohet)

Atëherë, pyes: a abstenon ndokush?

Lus Sekretarinë, le t'i numërojë abstenimet.

Konstatohet se Kuvendi, në të cilin marrin pjesë 100 deputetë, me shumicë votash “për”, me 3 vota “kundër” dhe 9 “abstenime” miratoi procesverbalet e datës 4 dhe 9 prill 2008.
Ju faleminderit shumë!

Kalojmë në pikën:

– Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 26 pika 1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është kufizuar në 50 minuta.

Po ashtu, ju njoftoj se koha e paraparë për parashtrimin e pyetjes, nuk mund të zgjatë më shumë se 1 minutë, ndërsa përgjigja jo më shumë se 3 minuta.

Pyetja shtesë, nuk mund të zgjatë më shumë se 1 minutë, ndërsa përgjigja shtesë nuk mund të zgjasë më shumë se 2 minuta.

Prandaj, lus që ata që pyesin dhe ata që përgjigjen, t'i përmbahen kësaj rregulle.

Në afatin e përcaktuar me Rregullën e Punës të Kuvendit, janë parashtruar 25 pyetje parlamentare.

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se, për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara dhe kohës së kufizuar në vetëm 50 minuta, së pari do të procedohen pyetjet e bartura nga seanca e kaluar dhe pastaj nga një pyetje të çdo deputeti, ndërsa të tjerat do të procedohen sipas radhës së parashtruar, në seancat e ardhshme.

Fillojmë me pyetjen. Fjalën e ka deputeti Driton Tali – nga AKR, pyetje për Kryeministrin, kurse prezent kemi zëvendëskryeministrat. Lus deputetin ta lexojë pyetjen.

DRITON TALI: Faleminderit zoti Kryetar!

Kjo pyetje është bartur prej disa seancave dhe, sidoqoftë, mediat kanë filluar të merren me të.

Çështja është se në fshatin Badoc ka filluar ndërtimi i 70 shtëpive dhe 20 banesave për serbë të kthyer aty, të financuara nga qeveria e Serbisë, përkatësisht Ministria e Infrastrukturës dhe Ndërtimit dhe ministrit të saj Velimir Iliq.

Siç dihet, nga ky fshat askush nga serbët nuk ka ikur, andaj aty po ngjanë në të vërtetë një koncentrim dhe kolonizim i ri i serbëve. Qëllimi është që të ndërlikohet territorialisht Graçanica me Artanën, e cila, si pasojë, do të ketë edhe marrjen e Liqenit të Badovcit.

Pyetja është kjo:

- A i ka këto informata Qeveria?
- Cili është qëndrimi i saj për këtë, dhe
- Cili është plani për t'iu përgjigjur kësaj ndërmarrje të Serbisë?

Është mirë të ceku edhe një herë se, Velimir Iliq, ministri për Infrastrukturë, thotë që “ky është veç fillimi i ndërtimeve që

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Përgjigjet zëvendëskryeministri Ramë Manaj.

RAMË MANAJ: I nderuari Kryetar! Të nderuar deputetë, ministra dhe zëvendëskryeministër,

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga deputeti Tali, përgjigja ka qenë edhe më herët e përgatitur dhe unë do të përpiqem, shumë shkurtazi, të them:

Qeveria, është në dijeni me këtë rast. Bëhet fjalë për një Memorandum të mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Kosovës, UNMIK-ut dhe Qeverisë së Serbisë në vitin 2006 i cili ka të bëjë me rindërtimin e 70 shtëpive, të cilat janë filluar, por nuk janë përfunduar dhe të cilat do të përfundohen me implementim të faktorit ndërkombëtar.

Çështja ka ngecur tek fakti se komuna e Prishtinës duhet të lejojë ndërtimin e këtyre shtëpive dhe iniciimi i procedurës për të marrë leje në Kuvendin e Komunës së Prishtinës ka qenë më i hershëm dhe ndërkohë është përsëritur me kërkesë të zëvendëspërfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Lari Rosin, dhe komuna e Prishtinës, ndonëse më herët e kishte ngritur këtë deri në Komitetin për Urbanizëm, besohet se së shpejti, në seancën e ardhshme dhe ndoshta në seancën e parë të Kuvendit të Komunës do të jepet leja për ndërtimin e këtyre shtëpive.

Këtu bëhet fjalë vetëm për kthimin e brendshëm, pra jo të zhvendosurit jashtë, por të zhvendosurit brenda Kosovës. Ky është kualifikim që buron edhe nga “memorandumi i

mirëkuptimit, i cili është nënshkruar nga përfaqësuesit e Qeverisë – përbërja e kaluar, të UNMIK-ut dhe të Republikës së Serbisë”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër! E ka fjalën deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti Kryetar!

Leja është dhënë nga Kuvendi Komunal, ndonëse Kryetari i Komunës së Prishtinës Isa Mustafa është deklaruar kundër kësaj ndërmarrjeje.

Siç dihet, në fshatin Badovc nuk ka pasur serbë, andaj aty kemi të bëjmë me rikolonizim, sikur që edhe thashë, zoti zëvendëskryeministër.

Zoti Isa Mustafa është deklaruar kundër, pos Qeverisë që nuk është deklaruar ende. Andaj edhe dua ta di qëndrimin e Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zëvendëskryeministër, a keni përgjigjen?

(Ndërhyrje)

Nuk kemi të bëjmë me debat dhe jo interpelancë. Jemi në pyetje e përgjigje dhe dihet kush i bën pyetjet dhe kush i jep përgjigjet.

RAMË MANAJ: Ju lutem, informatat që i kemi si Qeveri e Kosovës janë se leje nuk ka dhe ajo nuk është lëshuar. Përgjashtimisht mund të ketë ndodhur në seancën e fundit, për të cilën, unë personalisht, nuk kam informatë. Le të dëgjohemi, ju lutem. Kjo ishte e para.

Dhe, e dyta, Memorandumi precizon saktë. Bëhet fjalë për të zhvendosurit e brendshëm. Kjo është shumë e qartë se është memorandum i nënshkruar nga përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës, të UNMIK-ut dhe të Serbisë. Faleminderit!

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Ju lutem! Deputeti Gani Geci, pyetje për ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj. Lus deputetin ta lexojë pyetjen.

GANI GECI: Faleminderit zoti Kryetar!

Të nderuar ministra, kolegë deputetë,

Unë kam një pyetje për ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit të Kosovës. Në bazë të informatave të një qytetari të Kosovës, i cili kishte borxh 90 euro dhe posta e kishte ndërprerë telefonin, ai kishte shkuar në postë dhe kishte marrë vesh se Partia Demokratike e Kosovës i ka 30 mijë euro borxh dhe nuk ia ka ndërpre telefonin.

Pyes zotin ministër: A i kanë paguar, e di që i kanë paguar, por tash pyetja është tjetër – nga cili fond i keni paguar?

FATMIR LIMAJ: Unë s’po di qysh të të përgjigjem, a si ministër apo si PDK.

E para, mendoj se pyetja juaj, i nderuar deputet, me gjithë dëshirën për të marrë përgjigjen, nuk është çështje që ne merremi me atë. Ajo është çështje e shërbimit të brendshëm të postës. Mendoj se qasja për të dhënat në postë, është e drejtë e secilit dhe ju mund të merrni qasje si qytetar. Nuk është detyrë e Ministrisë së Transportit për ta bërë këtë.

Borxhi i partive politike, qoftë edhe të organizatave ose ndërmarrjeve tjera publike që i kanë dhe padyshim se aty duhet të jetë edhe Partia Demokratike, e ndoshta edhe Partia e juaj, tash e re, ka dhe mund të kenë edhe partitë tjera, por mendoj se nuk është temë e shqyrtimit të Ministrisë së Transportit. Prandaj, këto informacione të tilla, ju mund të shkoni e t'i merrni nëpër ndërmarrje tona publike dhe të keni qasje dhe informacione, që besoj se është e hapur për të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Urdhëroni!

GANI GECI: Problemi qëndron kështu! Në bazë të informacioneve nga viti 2005, Partia juaj nuk ka paguar telefonin dhe të gjithë dokumentacionin e kam këtu. Pagesa e parë, pasi e keni marrë pyetjen parlamentare, është bërë më 25. 3 dhe pastaj pagesa e dytë është bërë më 8.4, njëra është bërë për 5 mijë euro dhe tjetra me 26 mijë euro. Të dy pagesat, sipas informatave që kam unë, janë bërë me shkelje të ligjit dhe janë bërë nga ministritë. Prandaj, edhe më bëhet qejfi se ju – Partia Demokratike u bashkuat me ministritë e juaja. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, ministër! Fjalën e ka ministri Limaj.

FATMIR LIMAJ: Unë mendoj, qysh është bërë pagesa, nuk e di dhe kur ka filluar dhe mirë qenka bërë që është filluar dhe kushdo që e ka paguar dhe mirë është të paguhen shërbimet. Metoda për të spekuluar se është bërë nga Ministria, unë përsëri ju ftoj, nuk është mirë të spekuloni. Unë e kuptoj idenë e pyetjes tuaj, por nuk është mirë që të spekuloni se qysh e tek, por është mirë të shkoni atje dhe se secila parti e ka një fond të vetin dhe në qoftë se administrata e partive përkatëse do t'i kryejë ato shërbime është mirë që t'i kryejë. Unë ju ftoj, edhe Partinë Demokratike, edhe partitë tjera, të cilat kanë obligime ndaj ndërmarrjeve publike, jo vetëm të postës, po edhe të KEK-ut, edhe të ndërmarrjeve tjera – ti kryejnë obligimet ndaj këtyre ndërmarrjeve, pavarësisht nga cila parti politike. Nuk kisha dashur ta qesim në terrenin politik cila parti ka paguar e cila parti s'ka paguar, sepse edhe ti edhe unë, të gjithë jemi të vetëdijshëm se partitë politike kanë borxhe në ndërmarrje publike, qoftë në postë, qoftë në KEK dhe mirë është t'i kryejmë obligimet të gjithë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Naser Rugova, nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, ka pyetje për ministrin e shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Lus deputetin Naser Rugova ta lexojë pyetjen.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti ministër i shëndetësisë! Rasti i disa ditëve më parë kur ndalet energjia elektrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe për pakujdesinë e stafit teknik

dhe vonesës së aktivizimit të gjeneratorit, rrezikohet jeta e 30 pacientëve në Repartin e hemodializës, vërtet është më tepër se shqetësuese dhe nuk do koment. Ndërprerja e energjisë elektrike nuk rrezikon jetën e pacientëve vetëm në këtë repart, por edhe në repartet e tjera ku pacientët tonë luftojnë për jetën, si në inkubatorët ku ndodhin të porsalindurit, njësitë e kujdesit intensiv, sallat e lindjes, sallat e operacioneve dhe repartet e tjera me aparatura që varen nga rryma, gjë që po i vënë në sprovë dhe pozitë tejet të palakueshme kolegët tanë punëtorë shëndetësorë që po ballafaqohen me situata të vështira pa fajin e tyre. Këtu nuk përmend dëmet e konsiderueshme materiale dhe dëmtimin e aparaturave të shtrenjta.

Zoti ministër, kur do të ndërpriten praktikrat e tilla të papërgjegjshme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministri i shëndetësisë e ka fjalën.

ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar zonja dhe zotërinj, i nderuari zotëri deputet Naser Rugova, Duke mirëpritur interesimin tuaj për sigurim të rrymës në institucionet shëndetësore të Kosovës, në veçanti në Qendrën Klinike Universitare, ju përkujtoj zotëri se çështja e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike në vendin tonë, edhe përkundër angazhimeve dhe investimeve, është përcjellë me vështirësi dhe në kuadër të saj edhe në sistemin shëndetësor të vendit tonë, në industri të ushqimit si dhe në vijë të prodhimit dhe të depove ushqimore.

Qendra Klinike Universitare furnizohet në bazë të “prioritetit A+” dhe ka trafo të posaçme.

Lidhur me rastin konkret të mungesës së rrymës më 24 mars 2005, në orën 14,20 minuta, në Qendrën Klinike Universitare, ku është vendosur Reparti i dializës, me kënaqësi mund t’ju informoj me sa vijon:

24 marsi ka qenë ditë pushimi me rastin e Pashkëve dhe menjëherë, me të kuptuar se në Repartin e Hemodializës nuk ka rrymë, është vënë komunikimi në mes të zyrtarëve kryesor të shëndetësisë së vendit tonë, Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave deri në nivelin e funksionimit dhe rifunksionimit të Repartit të Hemodializës. Po atë ditë është kërkuar që komisioni i posaçëm i KEK-ut të ekzaminojë tërë çështjen dhe të paraqesë raport.

Po të nesërmen, gjatë vizitës në Qendrën Klinike Universitare nga ana ime, është biseduar lidhur me këtë incident dhe është vendosur që të ndërmerren të gjitha masat që një gjë e tillë të mos ndodhë më. Po të njëjtën ditë, me datë 25, Komisioni i ngritur nga KEK, në raportin numër 1614 ka konstatuar se nga ana e KEK-ut nuk ka pasur ndërprerje të rrymës, por gabimi ka qenë në gjeneratorin, i cili është në kuadër të KEK-ut. Të njëjtën ditë, më 25, Kryeministri, zoti Hashim Thaçi ka ftuar në takim të posaçëm urgjent tërë udhëheqjen më të lartë të Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Energjetikës dhe

Minierave dhe zyrtar të KEK-ut dhe me këtë rast është ripërsëritur ky konstatim që nuk ka pasur ndalje të rrymës dhe Kryeministri ka kërkuar që KEK-u të ketë furnizim të vazhdueshëm për Qendrën Klinike Universitare, me ç'rast është përgjigjur se ekziston trafo e posaçme për Qendrën Klinike Universitare. Përkundër kësaj, Kryeministri ka kërkuar dhe është ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputeti, a ka pyetje shtesë? Urdhëro! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti ministër! Ju po arsyetoheni se ka qenë festë, por 30 aparate të dializës dhe 30 pacientë për të cilët jeta e tyre varet nga ato aparate – për çdo festë të na përsëritet një “gërdec” në Qendrën Klinike Universitare, besoj se nuk ka koment. Ju faleminderit!

KRYETARI: Përgjigje, ministër?

ALUSH GASHI: Ju faleminderit, zoti Rugova! Unë fare nuk kam arsye të arsyetohem. Ju jeni deputet dhe edhe unë jam deputet, por si ministër që qëndroj në këmbë para juve jam i obliguar për korrektësi dhe kronologji. Në përfundim, ju them se ditën e nesërme, më 26, komision tjetër i KEK-ut ka konstatuar se ka pasur ndalje të rrymës dhe vendimi i Qeverisë së Kosovës është se, përveç trafos ekzistuese, të ekzistojë edhe një trafo e posaçme rezervë për këtë çështje. Atë ditë për shkak të ndërprerjes së rrymës, kyçjes dhe shkyçjes së gjeneratorit, ka ardhur deri te prishja e pllakës dhe pakos. Ne kemi qenë shumë korrektë në këtë çështje dhe nuk kam arsye të kërkoj falje dhe arsyetim.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetja e radhës. Deputetja Myrvete Pantina – LDK, pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi.

Meqë ministri nuk është këtu, do të kishim kaluar në pyetjen në vazhdim.

Deputeti Ibrhaim Makolli – AKR, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Edhe kjo nuk është këtu, por mund të përgjigjet zëvendëskryeministri, nëse pajtohet deputeti. Lus deputetin të deklarohej lidhur me këtë.

IBRHAİM MAKOLLI: Po, mendoj se mund të përgjigjet edhe zëvendëskryeministri. Megjithatë, Kryetar, unë kam para veti një renditje të pyetjeve të parashtruara nga ana e zyrës, që flet për një renditje krejt tjetër nga ajo që ju po thirrni për pyetje.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohet për transkriptim)

Po lexoj, në bazë të kohës kur janë dorëzuar në zyrë, zoti kryetar dhe do të kërkoja që herëve tjera të mos ndodhë kështu.

Çështja është: Paraardhësi i Ministrisë së Drejtësisë, ministri i Drejtësisë, zoti Salihaj, me rastin e grevës së të burgosurve në Burgun e Dubravës dhe kërkesës së tyre për amnisti, ka premtuar se ka garanci nga ana e Presidentit të Kosovës se do të shqyrtohet kërkesa e të burgosurve për të pasur të drejtën e amnistisë. Madje, me një premtim të tillë, edhe është arritur marrëveshja për ndërprerje të grevës.

Pyetja është kjo: A është duke ndërmarrë diçka ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka zëvendëskryeministri.

RAMË MANAJ: Faleminderit Kryetar!

Zoti Makolli, lidhur me pyetjen tuaj, të drejtuar Ministrisë së Drejtësisë se a është duke ndërmarrë diçka Ministria e Drejtësisë në lidhje me hartimin e Ligjit për amnistinë, në emër të kësaj Ministrie më lejoni të paraqes para jush qëndrimin, si në vijim.

Fillimisht është parë e nevojshme të shpjegohet se çështja e amnistisë dhe e faljes nuk janë të drejta të të burgosurve, por ato janë privilegje, të cilat të burgosurit mund t'i gëzojnë në raste dhe në kushte të caktuara.

Amnistia mund të bëhet për një numër të përcaktuar të veprave penale, e cila bëhet si amnisti e përgjithshme ose amnisti për vepra specifike penale, ndërsa falja iu jepet të burgosurve lidhur me një vepër penale dhe ajo iu jepet personave të caktuar me emër.

Sipas kornizës ekzistuese ligjore, autoriteti kompetent për të vendosur lidhur me amnistinë dhe faljen, është PSSP-ja, për shkaqet se Kushtetuta dhe ligjet nuk kanë hyrë në fuqi ende.

Nuk mund të themi se mungon bazë ligjore për të vendosur lidhur me këtë çështje, sepse legjislacioni në fuqi e njeh një gjë të tillë. Mirëpo, arsyeja se pse nuk aplikohet dhe përse nuk është aplikuar deri tani, është çështje që besoj duhet të pyetet organi kompetent, në rastin konkret, ende Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Sidoqoftë, Ministria e Drejtësisë, me rastin e bartjes së kompetencave dhe përgjegjësi në këtë fushë, do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm që ky projektligj të futet në strategjinë legjislative dhe të hartohet sa më parë.

Unë kam edhe pjesën e dytë të pyetjes dhe se a do të vazhdohet a jo, varet nga ju, zoti Makolli, sepse ka të bëjë me transferimin e shtetasve tanë të dënuar jashtë Kosovës dhe në qoftë se pajtoheni, për të mos e marrë dy herë fjalën të përgjigjem menjëherë. Atëherë, OK. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti, a ka pyetje shtesë? Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në pyetjen e radhës. Deputetja Myzejene Selmani – AKR, pyetje për Kryeministrin. Mund të përgjigjet zëvendëskryeministri. Lus deputeten ta lexojë pyetjen, nëse pajtohet. Urdhëroni, deputete!

MUZEJENE SELMANI: Furnizimi me energji elektrike në vend vazhdon të jetë në krizë tash e 9 vite, me tendencë që kjo krizë të thellohet edhe më tej.

Zoti zëvendëskryeministër, me datën 14 shkurt, me qëllim të tejkalimit të kësaj gjendje, keni shpallur krizë nacionale energjetike. Cilat janë masat e ndërmarra deri më tash dhe kur pritet stabilizim me energji elektrike? Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka zëvendëskryeministri.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë, zonja deputete,

Ju e dini që është e vërtetë se kemi shpallur në Qeveri krizë nacionale energjetike si rezultat i rrethanave që kanë qenë në gjendjen energjetike të Kosovës. Në këtë drejtim, Kryeministri, së bashku me disa ministra përkatës, kanë marrë masat adekuate, përfshirë ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në mbledhjen e parafundit të Qeverisë kemi nxjerrë një strategji prej 10 pikash. Ajo strategji parasheh, përveç rigjenerimit të kapaciteteve ekzistuese, mundësinë e privatizimit, koncesioneve dhe energjinë alternative me erë dhe me ujë.

Besoj që sot, në mbledhjen e Qeverisë, do të marrim një masë konkrete për shprehjen e interesit për “Kosovën A1” dhe “A2”. Në këtë drejtim, po marrim masa dhe shumë shpejt strategjia e miratuar në Qeveri do të fillojë edhe të implementohet. Është një punë e cila ka filluar, është trashëguar me shumë probleme, por besojmë se veprimet të cilat do të jenë me mundësinë e koncesionit, privatizimit, gjenerimit dhe vazhdimin e “Kosovës C” do të jemi në gjendje që ky premtim, që duhet ta them para qytetarëve mandator, dot ë realizohet.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a keni pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputetët, të cilët kanë bërë pyetje, do t’i sqarojë edhe një herë, të cilën gjë e thashë edhe në fillim.

Ju njoftoj se, për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara dhe kohës së kufizuar në vetëm 50 minuta, së pari do të procedohen pyetjet e bartura nga seanca e kaluar, pastaj nga një pyetje të secilit deputet, kurse të tjerat do të procedohen, sipas radhës së parashtruar, në seancat e ardhshme.

Këtë e lexova edhe në fillim të këtij rendi të ditës.

Po vazhdojmë punën. Deputetja Rita Hajzeraj – AKR, pyetje për ministrin e ekonomisë dhe të financave, zotin Ahmet Shala.

Lus deputeten, ta lexojë pyetjen.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Me shpresë që herën e ardhshme, në momentet e fundit mos ta ndryshoni renditjen e pyetjeve parlamentare, unë kisha dashur ta shtoj pyetjen time.

(Ndërhyrje – pa kyçje, nuk dëgjohet për transkriptim)

E sqaruat, por në momentin e fundit, Kryetar! Derisa ndodhin ngritje të njëpasnjëshme të çmimeve për mallra dhe shërbime, kurse paga e qytetarëve është fikse dhe e pandryshuar, me ç'rast kemi edhe rënie të fuqisë blerëse të parasë, e nga ana tjetër, nuk po shohim ndonjë iniciativë konkrete nga ana e organeve kompetente në lidhje me këtë çështje.

Zoti ministër, përderisa nuk kemi ngritje të të ardhurave personale dhe të pensioneve, në kontekstin e fuqisë blerëse, si arsyetohet fakti që kemi ngritje të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve dhe Ministria nuk ka marrë hapa konkret për normalizimin e kësaj gjendjeje.

KRYETARI: Ministri, Ahmet Shala, e ka fjalën.

AHMET SHALA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë, kolegë, zëvendëskryeministra,

E nderuara deputete, faleminderit për pyetjen! Është një preokupim global ngritja e çmimeve, sidomos në shportën e më të nevojshmeve dhe shtetet e ndryshme reagojnë konform mundësive që i kanë.

Neve, i kemi dy rrugë. Një, të ndërrojmë taksat dhe dy – të derdhim nga buxheti subvencione. Të dyja janë të dëmshme, sepse të dyja prapë godasin taksapaguesit. Andaj, e vetmja mënyrë është që në kuadër të politikave fiskale të cilat diku kah mesi i majit neve jemi duke i trajtuar si të ndihmohen njerëzit të cilët goditen më së shumti dhe ajo është pjesa e varfër.

Janë tri versione të cilat i kemi përgatitur, e për të cilat unë nuk do të doja as sot të diskutoj dhe versioni tjetër është si të lehtësohen çështjet e subvencioneve për shtresat më varfra dhe kur për subvencionet – zgjerimi i listës së pagesve të rrymës ose rritja e pensioneve dhe rritja e pagesave. Që nga viti 2001, faktikisht, nuk ka rritje të pagave, ndërsa inflacioni është përafërsisht 4% mesatarja vjetore.

Neve jemi duke bërë përpjekje që në kornizën afatmesme të shpenzimeve, në bashkëpunim me donatorët, ta trajtojmë këtë çështje dhe të prekim pjesët më të prekshme. Këto janë dy masa, të cilat do t'i përdorim dhe besoj që në mënyrë signifikante do të mbrojnë shtresat më të varfra por nuk do të tejkalojnë trendët globale të rritjes së çmimeve, sidomos në produktet bujqësore. Ju e dini që e gjithë bota është ngritur dhe nga vitet 29-35 nuk ka pasur krizë më të madhe financiare dhe turbulencë faktikisht në ngritjen e çmimeve në këtë drejtim, andaj neve do t'i marrim të gjitha masat që pjesa më e varfër mos të goditet.

Nuk mund të garantoj 100% se nuk do të goditet fare, por neve, në kuadër të mundësive dhe në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtar, besoj do të jemi në gjendje të kalojmë but këtë çështje. Kaq me këtë rast. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja, a ka pyetje shtesë? E ka fjalën deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti ministër! Shteti duhet të krijojë mekanizma për të marrë masa të menjëhershme për të mbrojtur qytetarin.

Zoti ministër, cilat janë ato preventiva tjera, apo keni ndonjë strategji tjetër që ne ende nuk po e shohim e cila do ta normalizonte këtë gjendje, apo do të prisni deri te fundi i durimit të qytetarëve, sepse deri më sot, nga udhëheqja dhe iniciativat tuaja drejt normalizimit të kësaj gjendje, nuk kanë sjellë rezultate.

KRYETARI: Ministër?

AHMET SHALA: Masat konkrete i thashë. Janë dy. Rritja e ngadalshme dhe e kujdesshme. Në kornizën afatmesme të shpenzimeve, e cila do të miratohet edhe në këtë Kuvend e jo më larg se më 15 maj, do të parashihen të gjitha masat. Nuk do të marrim hapa të cilët sot i vendosim, e nesër na i ç'vendosë vetë mekanizmi i tregut. Nuk do të marrim hapa të cilët do të vënë në pikëpyetje qëndrueshmërinë fiskale dhe qëndrueshmërinë buxhetore të Kosovës, por do të marrim masa, siç thash, në dy drejtime. Së shpejti do të rishikojmë me partnerët tanë ngritjen e pensioneve. Një. Dy. Me politikat fiskale, do t'i mbrojmë shtresat më të varfra. Dhe, tre, do të nxisim politikat të cilat do të nxisin prodhimin vendor i cili pastaj do të jetë në gjendje për të substituuar produktet të cilat vijnë nga importi dhe 80% dihet se vijnë nga importi deri më tani. Në qoftë se në tërë botën, pra ai 80% ka të çmimeve, neve jemi të pamundur të mbrohemi. E vetmja mënyrë pra është nxitja përmes politikave të qëndrueshme fiskale dhe politikave tatimore dhe ngritja ose mbrojtja e produkteve të personave me nevoja më të mëdha, siç janë pensionistët dhe ngritja e ngadalshme e rrogave. Së shpejti do të dalim me këto të tria, por vetëm me kornizën afatmesme të shpenzimeve, jo me ndonjë vendim administrativ të cilin pastaj e zhvendosim ne vetë nga forca e tregut.

Ky është sqarimi dhe unë do të thirrja edhe opozitën edhe të tjerët që së bashku t'i diskutojmë të gjitha politikat në kornizën afatmesme të shpenzimeve sepse ato janë për një periudhë afatmesme dhe afatgjate. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me pyetjen e radhës. Deputetja Gjylnaze Syla – AAK, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputete mund ta lexoni fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Aktualisht informatat shëndetësore në Republikën e Kosovës nuk grumbullohen në një qendër, por janë të shpërndara, një pjesë në Ministrinë e Shëndetësisë, një pjesë në Institutin Kombëtar, një pjesë në Qendrën Klinike

Universitare, spitalet rajonale e tjera. Kjo e vështirëson analizën e gjendjes shëndetësore, sepse nuk e dimë gjendjen e shëndetit të popullatës.

Prandaj, pyes ministrin: Pse Ministria e Shëndetësisë nuk ka formuar një sistem të integruar të informimit shëndetësor? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën.

ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë këtë pyetje nuk e kam marrë, por pasi që e kam pyetjen lidhur me neonatologjinë, dhe pasi është pyetje me të cilën ne merremi për çdo ditë dhe është një prej prioriteteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Qeverisë së vendit tonë, zonja deputete më lejoni t'ju them se ngritja e sistemit të informimit në shëndetësi është prioritet. Kemi filluar fitimin e mbështetjes nga Banka Botërore, kemi caktuar Grupin punues të SISH-it, do të thotë Sistemin Informativ Shëndetësor, do të dalim me propozim konkret për zgjerimin e projektpilotit, të cilin e ka financuar Qeveria e Luksemburgut për testimin e këtij modeli në Prizren. Mjetet për këtë sistem janë të atij niveli që buxheti ynë aktual nuk mund t'i mbajë, andaj do të fillojmë me këtë sistem gradual. Ndoshta, së pari, me të porsalindur, me pensionistët, si dhe përmes të ekzekutimit të regjistrimeve të cilat janë bërë në nivel të mjekësisë familjare. Një numër i të dhënave është realizuar, sepse është një projekt, të cilin e kanë vërejtur punëtorët shëndetësorë që nga dita e parë, se është i domosdoshëm dhe shpresoj se me regjistrimin gradual përmes mjekësisë familjare dhe me prodhimin e kartelave për pacientë, me anë të çipsit do të kemi mundësi që kur të fillojë një ditë edhe sistemi i sigurimeve shëndetësore që na sistemin ta kemi gati. Mendoj se këtë vit ne do ta zhvillojmë në pjesën më të madhe të vendit tonë dhe jemi kah provojmë ta përdorim sistemin aktual të internetit që posedon Qeveria e Kosovës në nivelin lokal dhe lidhjet qendrore. Me përmirësim të softuer-it qendror, ekzistojnë gjasat reale që kjo çështje të funksionalizohet apo të merret edhe modeli i cili është zhvilluar në Kroaci, të cilin e ka punuar Erixoni dhe Erixoni këto ditë është duke e përgatitur demonstrimin edhe për institucionet shëndetësore të vendit tonë, por problemi qëndron në qëndrueshmërinë financiare. Vendimi ynë është që ky sistem të zhvillohet gradualisht sipas mundësive tona materiale.

Me regjistrim të popullsisë këtë vit, shpresoj në nëntor, ne do të arrijmë që si pjesë e atij regjistrimi ta kemi edhe faqen tonë e cila na intereson me të dhëna dhe pajtohemi me ju që nuk do të merrem me të dhëna të përafërta të cilat shpesh krijojnë probleme në planifikim të furnizimit dhe në planifikim të zhvillimit të tërësishëm të sistemit shëndetësor.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Pyetje shtesë? E ka fjalën deputetja Gjylnaze Sylja lidhur me pyetjen shtesë.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, cilat janë sëmundjet më të shpeshta në Kosovë dhe lidhur me sistemin e informimit është se ju keni obligim ligjor – Ligji për shëndetësi, neni 68 specifikon se Ministria duhet të nxjerrë aktin nënligjor lidhur me sistemin unik të informimit shëndetësor. E keni nxjerrë këtë akt nënligjor?

ALUSH GASHI: Ju faleminderit shumë!

Ne nuk kemi mospërputhje se a duhet a s'duhet zbatu ligji. Lidhur me statistika për sëmundje ngjitëse, nëse ju e shtroni këtë pyetje, unë ua përgatis përgjigjen qoftë me gojë apo me shkrim. Të gjitha aktet e nevojshme nënligjore, që dalin nga Ligji lidhur me këtë çështje, i ka ekzistuar ministri edhe para meje. E ka formuar edhe zyrën e SISH – shërbimin informativ shëndetësor, ka ndarë një sasi të mjeteve, ka dërguar njerëz në trajnime, ka bashkëpunuar me Bankën Botërore, ka bashkëpunuar me UNDP-inë, ka bashkëpunuar me UNPF-in dhe me një numër shumë të madh donatorësh lidhur me këtë çështje në përpilimin e këtyre të dhënave. Mirëpo, ne nuk mund të jetojmë jashtë kontekstit të nivelit të zhvillimit të vendit tonë. Zhvillimi i këtij sistemi varet nga shëndetësia ekonomike e vendit tonë, për të cilin, ju e dini, e cilit nivel është. Ju mund të kërkonte “mercedes” por angazhimi im është për të mund ta sigurojmë një biletë të udhëtojmë me autobus, që do të thotë një fillim gradual i ndërtimit të sistemit dhe besoj se ky do të jetë vit i përmirësimeve të dukshme në këtë lëmi me vazhdimin e mbështetjes nga Qeveria e Luksemburgut për zhvillimin e multiplikimit të testit i cili është punuar në Prizren. Shpresojmë se do t'i rrisin mjetet edhe për 4 milionë që në vitet e ardhshme ta zhvillojmë atë në tërë vendin tonë. Edhe njëherë ju falënderoj për përkushtimin!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Deputeti Hajdin Abazi – Partia Demokratike, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcillar. Deputeti mund ta lexojë pyetjen.

HAJDIN ABAZI: Përshëndetje të gjithëve! Pyetja ime ka të bëjë me bifurkacionin e vetëm që ekziston në Kontinent, e ai ndodhet në komunën e Ferizajt dhe njëra pjesë që derdhet në Detin e Zi është e dëmtuar. Ka pasur një premtim nga Qeveria e kaluar, përkatësisht nga ministri përkatës se do të ndërmarre diçka, por nuk është ndërmarre asgjë.

Pyetja ime i drejtohet tani ministrit: Meqenëse është koha kur nevojiten të bëhen riparime që të shpëtohet dhe të ruhet funksionaliteti i bifurkacionit, çarë ka bërë, a ka ndonjë plan dhe çfarë do të bëjë Qeveria për të ndihmuar që të sanohet gjendja.

Theksoj se Kuvendi Komunal është i gatshëm po ashtu të participojë, por nuk mundet vet t'i mbulojë shpenzimet.

KRYETARI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën.

MAHIR YAGCILLAR: Faleminderit, zoti Kryetar!

Vërtet janë dy pyetje, sepse do të vjen edhe një pyetje tjetër, përafërsisht e njëjtë.

I nderuar Kryetar, të nderuar deputetë, ministra, i nderuar deputet Abazi,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor fenomenin e bifurkacionit e ka trajtuar si vlerë të trashëgimisë natyrore të rëndësisë së veçantë, sipas Ligjit për mbrojtjen e natyrës.

Fenomeni i bifurkacionit të lumit Nerodime është shpallur i mbrojtur nga ana e Kuvendit Komunal të Ferizajt në vitin 1979 dhe ai ishte organi kompetent për përkujdesjen e

drejtpërdrejtë. Vërtet mirëmbajtja e bifurkacionit të lumit Nerodime është nën çdo nivel, sa që ka filluar të humbë atributet që të jetë i tillë.

Bazuar në këtë gjendje, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, ka propozuar një projekt me prioritet të projekteve investime publike për vitin 2008 në vlerë të përafërt 50 mijë euro, e paraparë për financim nga buxheti i Kosovës. Po ashtu jemi në dijeni se Kuvendi Komunal i Ferizajt ka përgatitur një projekt për Konferencën e donatorëve, i cili kap shumën prej 419 mijë euro dhe po që se ndahen mjetet do të ketë veprime tjera që do të pasurojnë dhe do ta bëjnë funksional fenomenin e bifurkacionit.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetë, a keni pyetje shtesë? Jo. Faleminderit!
Vazhdojmë me pyetjen e radhës.

Deputeti Naser Rugova – LDD, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.
Deputeti mund ta lexojë pyetjen.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti ministër! Paradokset në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, e si rrjedhojë e kësaj edhe në Fakultetin e Mjekësisë, fatkeqësisht po vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Si është e mundur që në Fakultetin e Mjekësisë të zgjedhen asistentët në lëndët klinike, do të thotë kjo është pjesa shëndetësore, kandidatët të cilët nuk e kanë mbaruar specializimin.

Ku e shpijnë këto trende Fakultetin e Mjekësisë dhe Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe mjekësinë terciare?

Zoti ministër, kur do t'u thoni stop këtyre papërgjegjësive dhe shkeljeve të rënda në këto dy institucione kaq të rëndësishme për vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri e ka fjalën.

ALUSH GASHI: Faleminderit shumë, zoti deputet!

Çështja e zhvillimit dhe zgjedhjes dhe përzgjedhjes së kuadrit mësimor në Universitetin e Mjekësisë, në të vërtetë Universitetin e Kosovës në Prishtinë. E thash Universitetin e Mjekësisë sepse unë besoj është ardhur koha që Universiteti ynë i madh publik të krijojë mundësi të formohet si Universiteti i Mjekësisë dhe të mos ketë paradokse sikur kjo pyetje të cilën ju e bëni.

Lidhur me këtë çështje unë jam ballafaquar këto ditë, menjëherë pas marrjes së mandatit, me një vendim të qeverisë e cila ka kërkuar që të rishqyrtohen dhe shikohen të gjitha vendimet që janë marrë gjatë fushatës zgjedhore dhe deri në konstituim të Qeverisë së vendit tonë.

Zgjedhjet janë mbajtur më 17, kurse më 21 nëntor është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi në mes të ministrit të shëndetësisë dhe rektorit të Universitetit që t'iu jepen specializimet klinike asistentëve të zgjedhur në Universitetin e Prishtinës për Fakultetin e Mjekësisë.

Nga ajo dosje, ju përkujtoj se, specializimet në vendin tonë, sipas Ligjit, jepen me konkurs e jo me marrëveshje. Prandaj, unë nuk e kuptoj ende këtë dhe pres përgjigje dhe vendim nga Qeveria, aq më tepër kur këtu janë zgjedhur asistentë për lëndë klinike. Kjo do të thotë është zgjedhur dikush ta shpjegojë mjekësinë interne për studentë të Fakultetit të Mjekësisë pa e filluar fare specializimin dhe tash nga ministri kërkojmë që atij zotëriu apo zonje t'i lejohej fillimi i specializimit për dikë i cili është asistent për atë lëndë. Dhe këtu, problemi është se unë nuk e kam përvojën e vendeve tjera. Ai, po s'po e përmendi atë, se shumica prej këtyre kanë recensione negative nga Fakulteti i Mjekësisë. Kanë recensione nga komisioni recensues, kanë rekomandim negativ nga këshilli i arsimtarëve, por Senati e ka atë forcë që me vendimin e vet të merr vendim. Këtu unë i kam të gjitha ato vendime dhe ato mund t'ua ofroj.

Kjo çështje për mua ka mbetur e hapur. Pres vendimin e Qeverisë se si do të vendosë me këto raste. Specializimet ndahen me konkurs. Këtu është provuar që të bëhen specializime me marrëveshje dhe aq më tepër kur për lëmi që kërkohet të bëhet një përjashtim i madh, ne kemi me dhjetëra specialistë para Ministrisë me notë mesatare mbi 8, që kërkojnë vend pune.

Andaj, në pyetjen tuaj sa i përket se si janë zgjedhur, është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kujdes për kohën! Deputetë, a keni pyetje shtesë? E ka fjalën deputeti Rugova, për pyetjen shtesë.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti ministër, faleminderit për një përgjigje korrekte, por pajtoheni edhe ju se është një problematikë shumë serioze. Andaj, i ngelet Qeverisë, juve si ministër i Shëndetësisë, ministrit të Arsimit, patjetër, që kjo të diskutohet edhe në nivel qeveritar sepse, vërtet, nëse vazhdojnë këto trende, nuk di ku do të shkojë QKUK dhe Fakulteti i Mjekësisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Keni përgjigje? Nuk ke, se s'ke pyetje. Ishte koment. Vazhdojmë me pyetjen e radhës.

Deputeti Hajredin Hyseni – PDK, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Përgjigjen do ta japë zëvendëskryeministri Ramë Manaj. A jeni dakord për këtë? Atëherë, bëre pyetjen! E ka fjalën deputeti Hajredin Hyseni.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Tani po bëhen 9 vite nga masakra e regjimit serb në Burgun e Dubravës, një masakër që ngjanë në masakrën e Reçakut, ku u ekzekutuan mbi 100 të burgosur dhe u plagosën afër 300 të tjerë. Familjarëve dhe të mbijetuarve nuk iu lejohet as në përvjetorë ta vizitojnë vendin e ngjarjes makabër.

Shoqata e të Burgosurve Politikë, së bashku me të mbijetuarit, ka dy vite që ka përgatitur një projekt dhe iu ka ofruar institucioneve për realizimin e tij që më në fund edhe ne, si bota e qytetëruar, të dimë të çmojmë vetveten.

Deri më tani, nga institucionet nuk është bërë asgjë në këtë drejtim, edhe pse ka pasur premtime në të kaluarën.

Zoti zëvendëskryeministër, a ka marrë ndonjë hap Ministria në këtë drejtim dhe a ka pasur parasysh projektin e Shoqatës së të Burgosurve dhe të Mbijetuarve.

KRYETARI: E ka fjalën zëvendëskryeministri Ramë Manaj.

RAMË MANAJ: Faleminderit Kryetar!

I nderuari deputet Hyseni,

Unë fillimisht do ta prezantoj përgjigjen edhe në një pjesë të pyetjes që keni prezantuar më herët, e cila ka të bëjë me faktin se a ka marrë ndonjë hap Ministria lidhur me vizitat e familjarëve dhe të mbijetuarve të masakrës në Burgun e Dubravës në përvjetorët e kësaj masacre, sepse pyetja është shtruar kështu me shkrim dhe a e ka pasur parasysh Projektin e Shoqatës së të Burgosurve dhe të Mbijetuarve në Burgun e Dubravës.

Përgjigja është si vijon: Së pari, si çdo qytetar i Republikës së Kosovës, padyshim edhe ne të gjithë, me dhembje dhe pikëllim e respekt kujtojmë masakrën ndaj të burgosurve në Burgun e Dubravës, masakër e kryer nga regjimi barbar serb.

Së dyti. Sa për informimin tuaj, po edhe të gjithë të tjerëve, bëj të njohur se familjarët e të masakruarve në Burgun e Dubravës dhe të mbijetuarit që nga viti 2005, kur kompetencat janë bartur nga ndërkombëtarët tek vendorët, në ditën e përvjetorit e vizitojnë vendin e ngjarjes tragjike – vend pra ku janë masakruar të burgosurit shqiptarë.

Për shkak të natyrës së punës të këtij institucioni dhe për shkaqe objektive, në një rast, është kërkuar nga familjarët dhe të mbijetuarit që mundësisht të formojnë delegacion të tyre i cili do të vizitonte vendin e ngjarjes dhe jo të gjithë të interesuarit. Kështu është vepruar në vitin 2005. Kurse në vitin 2007 të gjithë familjarët e të masakruarve dhe të mbijetuarit kanë hyrë dhe kanë vizituar vendin ngjarjes tragjike.

Ministria e Drejtësisë, që nga fillimi i mandatit, ka treguar interesim maksimal që të bëhet një zgjidhje e duhur në këtë drejtim dhe konkretisht kemi siguruar mjetet e nevojshme dhe kemi bërë projektin për ngritjen e lapidarit për të masakruarit në Burgun e Dubravës. Ky projekt do të realizohet brenda afatit të caktuar dhe njëherit ju njoftojmë se në këtë përvjetor do të kemi lapidarin e ngritur për të masakruarit në Burgun e Dubravës. Ky lapidar do të jetë simbol i përkujtimit të masakruarve dhe i ngushëllimit të gjithë atyre që i humbën më të dashurit e tyre në këtë rast.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. A ka pyetje shtesë, deputeti? E ka fjalën deputeti Hyseni.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Unë vetë kujtoj se në të kaluarën nuk ka ndodhur ashtu dhe shpresoj në të ardhmen, vërtet, edhe familjarët dhe të gjithë, meqë jam në rrjedha të ngjarjes, sepse deri më tani familjarëve nuk iu kanë lejuar. Ka ndodhur vetëm një herë dhe herët, mirëpo më 2006 dhe 2007 mendoj se bartja nga Qeveria e kaluar s'ka qenë ekzakte dhe nuk iu kanë lejuar të hyjnë dhe ta vizitojnë vendin e ngjarjes. Ndërsa, për lapidar ekzistojnë të dhënat dhe nga Shoqata e të Burgosurve dhe të Mbijetuarit ka dy-tri vite që ekziston projekti, të cilin e kanë bërë me të hollat e veta dhe ua kanë ofruar institucioneve, prandaj edhe shpresoj se tash, më në fund, të bëhet dhe të realizohet kjo.

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj se nuk ka koment për pyetje shtesë. I kemi edhe katër minuta. Shkojmë në pyetjen e radhës.

Deputeti Riza Smaka – AKR, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Përgjigjet zëvendëskryeministri, nëse pajtohet deputeti.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohet për transkriptim)

Riza, mund ta merrni fjalën. Unë e kam sqaruar dy herë pse është bërë ashtu. Ju lutem, dëgjoni kur ta jap sqarimin. Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit zoti Kryetar!

Unë pyetjen time ia kam adresuar Kryeministrit të Qeverisë, jo për diçka tjetër, por për faktin se ndonjë ministër po di t'i shmanget obligimit elementar që të përgjigjet në mënyrë korrekte në pyetjen e deputetit. Kjo është esenca dhe jam thirrur në dispozitën kur jepet autorizimi që vet ose qoftë përmes zëvendësit apo ministrit të caktuar, të cilin unë e pranoj këtë me kënaqësi. Lus të jetë shkurtimisht dhe kjo kohë që e thashë të interpretohet sipas nenit 26 paragrafi 9, për kohë shtesë, mundësisht.

Dy pyetje i kam, por një do ta prezantoj.

Trusti i kursimeve pensionale është i bazuar në premisa krejtësisht të gabuara, funksionon krejtësisht gabueshëm...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, urdhëroni! Pyetjen e keni marrë dhe s'ka më kohë për pyetje.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Kryetar! Profesor Riza Smaka, besoj pyetjen tuaj e keni adresuar me shumë vend. Ne kemi pasur këtë një ndër brengat dhe ajo ka qenë rritja e buxhetit apo edhe shfrytëzimi i mundësive buxhetore me para të cilat momentalisht janë

jashtë vendit. Në mesin e tyre janë edhe të Trustit të Pensioneve. Në anën tjetër, përveç shumëve të tyre, për të cilat i kemi bërë një kërkesë që të bëhet bartja në buxhetin e Kosovës respektivisht të menaxhohet nga buxheti i Kosovës ose nga institucionet e Kosovës dhe kjo besoj se ka edhe një bazë juridike ngase me Kushtetutën e re të Kosovës është paraparë se të gjitha ndërmarrjet publike dhe pasuria e tyre, brenda dhe jashtë vendit, do të barten në Kosovë.

Pyetja juaj ka qenë e theksuar edhe për ndërmarrjet tjera publike dhe në Trustin pensional sa i përket të ardhurave që i kanë personat e caktuar, të ardhurat mujore, po i quajmë. Ne nuk kemi pasur autoritet mbi këto institucione. Ne e kemi një vetëdije të ekonomisë së lirë të tregut që nuk nënkupton se do t'i standardizojmë me pagën që është nga buxheti i konsoliduar të Kosovës por kurrësi nuk do të pajtohemi me këtë. Ne kemi pasur kontakte të drejtpërdrejta edhe me përfaqësuesit e AKM-ës, kemi pasur kontakte të drejtpërdrejta edhe me përfaqësuesit e Trustit Pensional dhe kemi kërkuar rishikimin e kësaj gjendje. Besoj se pas 15 qershorit do të kemi mundësi që të marrim masa konkrete.

KRYETARI: Faleminderit. Pyetje shtesë? E ka fjalën deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Nuk është morale që pensionisti të marrë pensionin 45 euro, e nga paratë e pensionistëve menaxheri dhe menaxhmenti dhe stafi profesional e teknik të marrë paga me qindra herë më të larta. Do të thotë, është totalisht e palejueshme dhe duhet Qeveria t'i ndërmarrë të gjitha masat e mundshme dhe ta rregullojë këtë çështje tepër irituese dhe tepër provokuese. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Konstatoj se koha për pyetje dhe përgjigje është kryer. Tani do ta japim një pauzë për kafe. Pauza zgjat 20 minuta, sa për ta pirë nga një kafe.

Vazhdimi i seancës pas pauzës

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Zonja dhe zotërinj deputetë. Do të vazhdojmë me seancën plenare të ditës së sotme dhe në rend të ditës është:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sponsorizime në kulturë, rini dhe sport

T'ju përkujtoj se në sallë janë 64 deputetë, së këndejmi janë plotësuar kushtet që të vijojmë me punë.

Gjithashtu, më lejoni t'ju përkujtoj se Projektligji për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport u është shpërndarë deputetëve më kohë, dhe se tani janë krijuar kushtet për shqyrtim dhe miratim.

Për të bërë një gjë të tillë, më lejoni të ftoj zonjën Lirije Kajtazi, ushtruese e detyrës së ministrit për Kulturë, Rini dhe Sport, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

LIRIJE KAJTAZI: Përshëndetje, i nderuari zoti Kryeziu,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra, paskan shkuar, vetëm një qenka këtu.

Ofroj para jush, meqë ju keni marrë Ligjin për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport. Kam kënaqësinë që sot të ofroj këtë Projektligj, koncipimin, strukturën, efektet pozitive që mendohet të arrihen me zbatimin e këtij Ligji.

Qëllimi i Projektligjit për sponsorizime në kulturë, rini dhe sport është rregullimi juridik i veprimtarive sponsoruese, si dhe përcaktimi i përgjegjësisë të bartësve në menaxhimin me te, veprimtaritë e interesit publik dhe mbështetjen institucionale në realizimin e programeve të zhvillimit të aktiviteteve kulturore, sportive e rinore, qoftë në interes të përgjithshëm, qoftë edhe ato të interesit lokal.

Me këtë Projektligj, një dispozitë e veçantë u kushtohet përkufizimeve themelore të nocioneve në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të sponsorimeve.

Qëllimet dhe synimet që përbëjnë kapitull në vete, fokusohen në nxitjen dhe zhvillimin e sponsorimeve për të gjithë dhe institucionalizimin e këtij aktiviteti sipas përvojave evropiane dhe ndërkombëtare përgjithësisht. Vëmendje e veçantë u kushtohet gjithë pjesëmarrësve në veprimtaritë sponsoruese, veçanërisht kategorizimit të tyre, procedurave, kritereve që duhet të kihet parasysh nga kjo lëmë.

Një kapitull i Projektligjit përkufizon marrëdhëniet sponsoruese, ndërsa një tjetër raportin e komunitetit biznesor përgjegjës për sponsorime dhe të organizatave të tjera sponsoruese, duke i vënë këto në një mbikëqyrje të ligjit në rast të parregullsive në punë ose të shkeljeve të parimeve që i përcakton Ligji për veprimin e organizatave, të ndërmarrjeve apo të korporatave sponsoruese.

Në procesin e hartimit të Projektligjit është marrë parasysh numri i madh i sugjerimeve nga anëtarët e grupit hartues dhe si i tillë u përgjigjet kërkesave të brendshme dhe standardeve të përgjithshme.

Mungesa e infrastrukturës juridike nga disa fusha të veçanta, në këtë rast privatizimi dhe disa çështje të tjera të ekonomisë, ka ndikuar që në Projektligj të ketë edhe norma që përmbajnë vetëm parime konkrete, por që ndërkohë do të harmonizohen dhe precizohen me udhëzime administrative të veçanta nga Qeveria.

Ky Projektligj ka të bëjë afërsisht me të gjitha rastet, llojet, mënyrat dhe modelet sponsoruese që ofrojnë shërbime për realizimin e aktiviteteve kulturore, sportive e rinore, pavarësisht nga përkatësia institucionale apo pronësore.

Në procesin e hartimit të tij është bërë përpjekje që i njëjti, krahas promovimit të frymës bashkëkohore, njëkohësisht edhe të saktësojë dhe qartësojë të drejtat dhe përgjegjësitë e komunitetit biznesor, të personave fizikë e juridikë lidhur me mbështetjen, mbikëqyrjen, administrimin dhe financimin në sponsorimin e aktiviteteve kulturore, rinore e sportive,

të saktësojë e të garantojë të drejtat e qytetarëve për aktivitete sponsoruese në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë dallim diskriminues dhe kështu të shprehë në tërësi standardet demokratike ndërkombëtare nga kjo fushë.

Të fusë detyrimin e çdo sponsori për të respektuar vendosjen ligjore e normative. Të sanksionojë si kundërvajtje veprimet apo mosveprimet që janë në kundërshtim me mënyrën dhe kushtet e ushtrimit të veprimtarisë sponsoruese si dhe ato që cenojnë të drejtën e sponsoruesve në shërbim të kësaj çështjeje.

Rregullimi i shumë çështjeve me rëndësi praktike për aktivitetin sponsorues, e që ka të bëjë me zbatimin e dispozitave të ndryshme të Projektligjit, do të bëhet me akte nënligjore, që është praktikë e zakonshme legjislative.

Të nderuar deputetë,

Me shpresë se jam përpjekur fillimisht t'i qartësoj parimet themelore si dhe qëllimet dhe synimet e Projektligjit për sponsorim të aktiviteteve të kulturës, rinisë dhe sportit, Ju ftoj që ta mbështesni së pari në korrektësi, pastaj dhe në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Lirije!

Tani në radhë i kemi deklaratimet e kryetarëve të grupeve parlamentare, pastaj edhe të atyre që janë paraqitur për të marrë fjalën.

Memli Krasniqi do të flasë në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministër,
Kolegë deputetë,

Projektligji që kemi para vetes për ta shqyrtuar trajton një lëndë shumë të rëndësishme dhe si Projektligj është mjaftë i vonuar. Mungesa e tij në fakt ka shkaktuar probleme në dinamizmin e jetës kulturore, po ashtu të aktiviteteve rinore dhe sportive në vend. Besojmë se miratimi i tij sa më i shpejtë mund të kontribuojë në ringjalljen edhe diversifikimin e aktiviteteve të kësaj fushe.

Ligji është shumë i rëndësishëm dhe është me rëndësi që të miratohet pas përpunimit sa më të shpejtë, por kështu si është, ky Ligji ka definitivisht nevojë për përmirësime të theksuara, ndoshta duke filluar nga titulli i tij, i cili pak është fluid në kuptimin që nuk e saktëson çka do të thotë sponsorizime, ta zëmë, në rini. Pastaj, ka probleme, memorandumit shpjegues nuk përputhet me projektligjin, në memorandum flitet për 22-23 nene, Projektligji ka 17. Gjuha juridike, në fakt këtë e kemi diskutuar edhe në grup parlamentar, nuk është e një niveli të duhur për këtë Projektligj. Ka edhe disa paqartësi edhe ambiguitete të tjera. Përmbi të gjitha mendojmë se adoptimi më i rëndësishëm që duhet t'i bëhet këtij Ligji është adoptimi në kontestin e ri politik në shtetin e pavarur të Kosovës dhe kjo ka konsekuenca sidomos në fushën e sportit dhe në ndërkombëtarizimin e sportit të Kosovës. Po ashtu, besoj se për shkak të qëllimeve kryesore të këtij ligji që

ndërlidhen edhe me lehtësimet për sponzorizuesit, duhet ta përshtatim ndoshta bashkërisht edhe me pakon e re fiskale, e cila është në përgatitje e sipër nga Qeveria.

Edhe pse i kemi shënuar këto probleme, kisha për të thënë, meqenëse ky ligj ka 2 vite që është duke u sjellë dhe besoj që këto probleme kanë mbetur prej përgatitësit të mandatit të kaluar. Me qenë se rregullimi i kësaj fushe duhet të konsiderohet si mjaft urgjent, ne e mbështesim në parim me qëllim që në komisionin përkatës ta përpunojmë dhe ta adoptojmë ashtu si kërkojnë rrethanat e sotme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Krasniqi!

Shkojmë me Grupin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotëri Adem Hajdaraj e ka fjalën.

ADEM HAJDARAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes, zotëri zëvendëskryeministër, ministër
Deputetë të nderuar,

Ne në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e kemi lexuar me vëmendje këtë Ligji, e kemi shqyrtuar dhe na duket se janë përcaktuar mjaft mirë disa çështje, në radhë të parë përkitazi me financimin, por edhe pikat që trajtojnë, çështjet që trajtojnë në këto 17 nene, respektivisht në tri pjesë të ligjit.

Pra, mendojmë se përkufizimet janë të mira dhe mjaft precize, që na thotë mendja se deri më tash ndonjë ligj kaq preciz nuk e kemi hasur këtu prej se kemi ardhur. Do të thotë, është precizuar dhe shprehjet janë mjaft të thukëta, nuk lënë dilema sado që ka aty këtu mangësi për të cilat duhet më tej të diskutojmë.

Do të thotë, sa u përket vlerësimeve tona, edhe format e sponzorizimit, njëkohësisht edhe shpenzimet shitesë gjatë zbatimit të ligjit janë paraparë mirë, duke tërhequr vërejtjen se nëse ka keqpërdorime përkitazi me sponzorizimin, atëherë janë ato mjetet ligjore të cilat do ta ndëshkojnë këtë. Sponzorizimi me qëllim parësor të përfitimit ekonomik është i ndaluar. Kjo është mirë që është theksuar në Ligj.

Përndryshe, edhe format e sponzorizimit, edhe mënyrat e sponzorizimit, edhe tipat dhe llojet e sponzorizimit në pika të veçanta që janë shtruar këtu, janë mjaft precize, me ndonjë lëshim aty - këtu që do ta shohim gjatë leximit të dytë.

Prandaj, Grupi ynë Parlamentar në parim e mbështet këtë Projektligj, i cili kujtoj se do të kalojë edhe më tej. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Hajdaraj!

Shkojmë te Grupi Parlamentar i AKR-së, ne e kemi Esat Brajshorin këtu, a është e vërtetë që ju do të flisni në emër të grupit?
Zotëri Esat Brajshori e ka fjalën.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më në fund, konsiderojmë se është një lajm i mirë sot që në Parlamentin e Kosovës vjen ky Projektligj për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sport. Është një lajm i mirë.

Ky Kuvend sot ka shtruar përpara vetes shqyrtimin e parë të Projektligjit për sponsorizimet në kulturë, rini dhe sporte dhe, thënë sinjerisht, për mua sot kjo paraqet një nga ditët më të veçanta në këtë Kuvend, si deputet i ri. Kjo për faktin se gjendja në gjithë këto fusha, që i përthekon ky Projektligj, është tepër e stërkequr, për të mos thënë se ka prekur kufijtë e dhimbjes nacionale. Siç duket, dinamika e rrjedhave politike tek ne ka bërë që këto kategori suplementare të nxirren jashtë funksionit dhe rolit që kanë në drejtim të civilizimit të kombit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Projektligji në fjalë në mënyrë eksplicite, në disa nene sidomos, është shumë i saktë, mendojmë ne. Ka nevojë për dy amendamente të reja, që ne do t'i paraqesim në qoftë se merr votën e shqyrtimit të parë. Si Grup Parlamentar, në parim e mbështesim këtë Projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Brajshori!

Në radhë është Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e kemi këtu zotëri Rasim Selmanajn.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Diskutimi i këtij Projektligji në Kuvendin e Republikës së Kosovës domosdo shënon një ngjarje të mirë për kulturën, rininë dhe sportin. Do të dëshiroja që kjo ditë e sotme vërtet të jetë një fillim i mbarë që më në fund të ngjallen shpresat e humbura të njerëzve të kulturës, të rinisë dhe të sportit.

Që nga përfundimi i luftës e deri më sot, përkrahja për këta njerëz ka qenë tejet minimale, për të mos thënë zero. Do të dëshiroja të kthem në retrospektivë në Kosovë, në vitet '90-ta. Në Kohën e regjimit të Milosheviqit ka pasur gjallëri më shumë të aktiviteteve kulturore, sportive sesa sot, në vend që të ndodh e kundërta. Ne jemi të vetëdijshëm se në atë kohë jemi munduar të kemi organizime paralele edhe ka qenë një sakrificë e këtyre njerëzve, mirëpo ata njerëz tash janë të zhgënjyer për faktin se, në vend që të kem përkrahje, tash pas luftës po ndodh e kundërta.

Unë mendoj se shumë pak është bërë në këtë drejtim në përkrahje të njerëzve të kulturës, të rinisë dhe të sporteve. Gjithkund thuhet nëpër nivele të komunave, por edhe nivel të qendrës se s'ka para komuna, s'ka Qeveria. Unë mendoj që është mirë të mendohet shumë më seriozisht që të ketë një përkrahje institucionale për këta njerëz të kulturës, të rinisë dhe të sportit. Ajo çka është për të ardhur keq, sot i vetmi aktivitet për rininë dhe për shumicën e njerëzve të sportit janë shndërruar bastoret. Këta njerëz s'kanë ku ta humbin kohën, këta nuk kanë mundësi të zhvillojnë aktivitete kulturore.

Prandaj, konsideroj se nxjerrja e këtij Projektligji, aprovimi i këtij ligji në këtë Kuvend është një ngjarje e mirë edhe kujtoj se përkundër disa vërejtjeve që u dhanë, është ligj i mirë që meriton përkrahjen.

Do të dëshiroja në këtë rast ta shfrytëzoj rastin se është po ashtu një lajm i mirë zgjedhja, më në fund, e një njeriut të kulturës Valton Beqiri, pra si ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe shpresoj se ky ministër, në të ardhmen, me buxhetin prej 9 milionëve do të mendojë për investime konkrete në kulturë dhe, si propozim konkret, një palestër sportive në Deçan.

Në fund, e përkrah këtë Projektligj, në parim, dhe vërejtjet eventuale do t'i paraqesim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Selamanaj!

Zonja Drita Maliqi është paraqitur, supozoj për Grupin Parlamentar të LDD-së. Urdhëroni, e keni fjalën!

DRITA MALIQI: Faleminderit, përshëndetje!

Edhe pse i vonuar, vlerësojmë se ky Ligj është me rëndësi, prandaj e përkrahim, në parim. Me qenë se sponsorizimi i projekteve dhe i aktiviteteve kulturore e sportive, rinore për Republikën e Kosovës në këtë fazë të zhvillimit është me rëndësi kapitale, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah në parim dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit edhe juve!

Tani në radhë është Grupi “7+”, zotëri Enis Kervan është paraqitur.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zotëri kryesues!

“7+” Parlamentar grubi Kultur, Gençlik ve Spor alanında Sponsorluk Yasa Tasarısının bu alandaki yatırımların kaçınılmazlığını gözönünde bulundurarak, özellikle gençlerimizin kültürel, spor ve çeşitli sosyal alanlardaki faaliyet eksikliklerini de gözönünde bulundurarak, prensipte Yasa Tasarısını kabul etmektedir , ancak tamamlamalarını varolan komisyonlarda sizlerle paylaşacaktır. Sağolun.

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Kervan!

Grupi SLS, zotëri Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani gospodine predsjedavajući,
Drage kolege poslanici,

Parlamentarna Grupa Samostalne liberalne stranke na vreme je dobila Nacrt zakona o sponzorisanju u sportu. Međutim, moram da kažem da ćemo kroz funkcionalne komisije imati dosta posla što se tiče srpske zajednice. Slažem se da je Zakon nepohodno usvojiti zato što se radi prvenstveno o mladim ljudima, mada kultura ne podrazumeva samo da

budete mlad. Omladina i sport naravno da, i to je vrlo bitno pitanje i vrlo bitna tema, zato što se radi o mladim ljudima bez obzira na pripadnosti bilo koje zajednice, predstavlja dobru bazu i sirovinu da se radi sa njima, znači od njih da postanu dobri ljudi koji će kasnije znati implimentirati dobre stvari.

Međutim, možda je do prevoda na srpskom jeziku, neke stvari po nekim članovima u tom zakonu su apsolutno bespredmetne. Znači, ne možemo da tačno kažemo o čemu se radi, tako da će nam trebati dodatno vreme. Naravno, rekao sam kroz funkcionalne komisije tražim od vas razumevanje zato što se radi o jednoj manjinskoj zajednici kojoj takođe treba da bude pružena jedna određena vrsta pomoći, ne samo srpskoj, nego i drugim zajednicima, i sve ono što budemo smatrali da nije u protivnosti sa ostalim zakonima ili sa stavovima većinske zajednice, mi nećemo zahtevati, međutim ono što smatramo da je dobro za srpsku zajednicu, mi ćemo kroz komisije nastojiti da implementiramo kako bi zakon bio što bolji i što vredniji. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Stojanoviq!

Në këtë mënyrë e kemi mbaruar listën e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Do të shkojmë tash me deputetët që janë paraqitur për fjalë. Në radhë është zotëri Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë dhe të pranishëm,

Pajtohem se ky Ligj është shumë i rëndësishëm dhe duhet proceduar më tutje. Por, për mendimin tim, ky Ligj i është shmangur gjuhës juridike dhe në disa vende do të thosha ka marrë si formë të artikullit të gazetës, që do të kishte për temë sponzorizimin në kulturë. Kjo formë e përcjell edhe nenin 12, që do ta veçoja. Sipas mendimit tim, ky nen duhet të jetë i përcjellë me disa paragrafe shtesë që gjatë procedimit në komision funksional mendoj se do të duhej të merrej parasysh.

Këtu duhet precizuar se deri në sa përqindje të fitimit të ndërmarrjeve e të bizneseve mund të ndahen për sponzorizim në kulturë. E kam fjalën për atë pjesë që duhet të hiqet prej tatimit të përgjithshëm. Mendoj se kjo është diçka elementare edhe e domosdoshme, sepse firmat nuk mund ta ndajnë gjithë fitimin, gjithë tatimin jashtë obligimeve për buxhetin e shtetit, gjë që nuk është precizuar, e do të duhej të ishte precizuar në Ligj.

Megjithatë, siç e thashë edhe në fillim, këtë Ligj shumë të nevojshëm për zhvillimin e kulturës në Kosovë e përkrah dhe kërkoi gjatë shqyrtimit të komisionit funksional të punohet me shumë kujdes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit edhe juve, zotëri Xhemajli!

Në radhë është zotëri Hydajet Hyseni Kaloshi.

HYDAJET HYSENI KALOSHI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që duke përshëndetur zëvendësministrin për prezantimin, po e bën për herë të parë dhe dëshiroj ta përshëndes veçanërisht, madje jam i lirë edhe ta bëjë një vërejtje. Nëse zëvendësministri prezanton një ligj, do të ishte e rregullt që ai edhe të zë vendin e ministrit, është zëvendësministër, prandaj nuk më duket në rregull që të dilet prej rreshtit të fundit, të prezantojë ligjin dhe të kthehet atje.

Sido që të jetë, unë dua ta përshëndes edhe nismën për ta rregulluar me Ligj çështjen e rëndësishme të sponsorizimit. I duhej Kosovës një Ligj i tillë dhe besoj që efektet do të jenë pozitive. Na është ofruar një Ligj solid, do të thosha, por konsideroj të nevojshme që edhe në këtë diskutim të mprehim pak vëmendjen tonë edhe në disa çështje funksionale të cilat mund të ketë nevojë që të sqarohen në të ardhmen.

Që në fillim, ligji është definuar, është ngushtësuar si Ligj për sponsorizimet, vini re, në fushën e kulturës, rini dhe sport. E theksoi edhe parafolësi, në emër të grupit parlamentar, natyrisht e mbështes. Shtrohet çështja, a duhet të shkojmë për sponsorizime në secilën ministri, siç janë ndarë, apo ta rregullojmë fushën e sponsorizimeve në përgjithësi. Çka, për shembull, me sponsorizimet në fushën e shkencës, të bamirësisë, në aktivitetet e ndryshme të shoqërisë civile, e të tjera.

Mendoj që emri duhet të jetë: “Ligji për sponsorizimet” dhe aty pastaj të ketë vendin e vet edhe kultura, sporti, rinia, e tjera. Për më tepër, që në nenin e parë, po ta vëni re me kujdes, në gjuhën shqipe është kjo formulë: “Me këtë Ligj në formë sponsorizimi, në formë rregullohet mbështetja materiale e financiare në kulturë, rini dhe sport”. Kuptohet tash që me formë sponsorizimi dikush po e rregullon mbështetjen materiale në rini e sport. Në anglisht është ndryshe, rregullohet mbështetja materiale e financiare në formë sponsorizimi. Edhe në serbisht është keq. Përkthimet e gabuara mund të jenë të kuptueshme nëse nuk e ndryshojnë substancën e Ligjit.

Për më tepër, në paragrafin vijues të të njëjtit ligj, thuhet: “Sponsorizimet dallohen nga donacionet e tjera dhe mbështetja e përkrahja materiale financiare”. Ligji në nenin 1 e identifikon plotësisht sponsorizimin në mbështetjen financiare materiale, në nenin 2 thotë duhet të dallohet nga kjo, kurse në nenin 4, te përkufizimet, përsëri sponsorizimi përshkruhet si mbështetje materiale financiare, në natyrë, e tjera. Duan precizuar këto çështje, sepse në praktikë shkaktojnë ngatërime serioze.

Po ashtu, në deklaratën financiare, e cila i është bashkangjitur Ligjit, sipas rregullave të procedurës, nuk di nëse është një lëshim teknik apo një pakujdesi, por deklarata është e vitit 2006. Ka edhe një parim, sipas të cilit, nëse një nismë ligjore nuk është përfunduar brenda legjislaturës, ajo duhet pastaj të fillohet nga e para.

Në Ligjin, ta zëmë, për Ansamblin “Shota”, që e kemi, Ministria ka bërë një deklaratë të re, në të cilën e ka rishikuar edhe një herë deklaratën e mëparshme financiare, por është e pakuptueshme që tani ligjin ta miratojmë me një deklaratë të para 2 – 3 vitesh.

Megjithatë, edhe përkundër këtyre vërejtjeve, besoj që këto janë vërejtje që mund të korrigjohen dhe besoj që do të merren parasysh gjatë amendimit. Ligji mendoj që meriton përkrahje dhe do t'i ndihmojë Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Hyseni!
Në radhë është zotëri Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!
Ne dëgjuam një pëlqim, nga pak me ndjenja, të njerëzve që i ka prekur kultura, rreth këtij Ligji. Po e shoh që u gëzuan të gjithë. Sigurisht që është një Ligj që kodifikon një veprimtari e cila ka ekzistuar këtu, vetëm ka ekzistuar pak në formën e xhunglës.

Unë mendoj që ky do të fus një rend dhe, sigurisht do të fus një rend. Mbi të gjitha, do të jetë një ndihmë për zhvillimet në kulturë dhe në sport. Rinia mund të jetë edhe në sport, edhe në kulturë. Më shumë në sport, kur janë më të ri, por më vonë, edhe këndeje, edhe andej, do me thënë, po luaj pak me përkufizimin e titullit, i cili mund të precizohet.

Natyrisht, unë vetëm po theksoj këtu, meqë e kemi përpara këtë Ligj, që për veprime kulturore fundamentale duhet të ketë financa shtetërore, dhe unë dua ta theksoj këtu. Nuk duhet të presim që ato që quhen strategji kulturore, nacionale, se u përmend këtu edhe shkenca, edhe kultura, edhe krijimtaria. Pa financim shtetëror ato nuk ndodhin, sepse janë veprimtari elite joprofitabile dhe ato nuk zgjidhen me këtë Ligj. Sido që të jetë, kjo u jep një fuqi frymarrjeve, veprimeve dhe sponzorizimeve.

Unë e kam lexuar, natyrisht, me kujdes si të gjithë kolegët e mi dhe unë e pash që edhe ata e kanë lexuar kujdesshëm, se kanë parë pika që duhet të korrigjohen menjëherë, duke filluar nga neni 1, që kolegu Hyseni e përmendi. Nëse thuhet që sponzorizimi dallohet nga donacionet, ndihmat, e tjera, duhet të jepen këto përkufizime saktësisht, që këtu mungojnë. Bile, ai saktësim, neni 4, po më duket është, i precizimeve të nocioneve, është mirë të qitet bile i dytë, nëse jo i parë, të bëhet një rrotullim i pozicioneve të neneve.

Keni nenin 3.3, te faqja 4, që për mua është indikativ, që duhet të thuhet: "Sponsorizimi me qëllim parësor të përfitimit ekonomik është i ndaluar". Kjo është lapidare shprehja ligjore, kur ta shihni, vetëm në një ligj kjo duhet të precizohet, kusht është ai dhe me cilën masë e matë që një sponsorizim nuk e ka qëllim parësor përfitimin. Do me thënë, qëllimi është i mirë, përkufizimi mungon.

Ka edhe një përkufizim i saktë që të bëhet te lehtësitë tatimore, që mua më duket kolegu Emrush Xhemajli e pa, nëse jo ai, dikush tjetër e pa. Duhet të saktësohet, cila njësi lirohet krejt prej tatimit ose lirohet kaq për qind prej tatimit. Është një referencë e një ligji atje, por unë mendoj që duhet të precizohet dhe këtu brenda, mos të bëhet referenca e atillë në ligj, se është pak problematike.

Dhe, në fund, atë që e tha folësi i parë, Krasniqi, Memli e tha, duhet të shkruhet te këto ligjet që i nënshkruan Kryetari i Kosovës, i jep PSSP, sepse unë dyshoj që ky do të kalojë e do të bëhet funksional deri në qershor. Duhet tash definitivisht të paraprijnë me

formulimet edhe hyrëse edhe dalëse, edhe hyrëset janë me Kornizë Kushtetuese, edhe dalëset janë me PSSP. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Hamiti!
Tani e ka radhën zotëri Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zotëri kryesues!
Të nderuar zëvendëskryeministër, ministër, deputetë,

Të them të drejtën, unë ndoshta e kam një mendim të veçantë nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Unë mendoj që është propozimi imi, është mendimi i imi, prapë e them, si deputet, ky Ligj kisha menduar që t'i kthehet prapë Qeverisë në shqyrtim, edhe Ministrisë adekuate.

Prej fillimit e deri në fund, po të lexohet me vëmendje, edhe nenet, edhe qëllimi, edhe objektivat, bien ndesh me njëra tjetrën.

Unë vetëm do të ndalem, e tha edhe profesor Hamiti, është sponsorimi me qëllim parësor, përfitimi ekonomik është i ndaluar. Ndërsa, te neni 6 kemi fuqia e krijimit, përkatësisht do me thanë te realizimi, arritja, bartja dhe ngritja e reputacionit të shoqërisë tregtare, persona fizikë tjetër.

I mungon gjuha juridike, nuk ka masa ndëshkuese ndaj atyre të fundit, ka shumë, shumë gjëra që bie ndesh me qëllimin, edhe pse shumë i nevojshëm ndoshta do t'i dalë shumë punë komisionit funksional që ta bëjë një renditje të mirëfilltë.

Është i ndaluar përfitimi ekonomik, ndërsa këtu është shtimi i marketingut dhe i shitjes, por cila është ndalesa që i bëhet këtij përfitimi ekonomik?

Mos të flas për nene të tjera, apo ndonjë shprehje tjetër ta gjejë, siç e tha kolegu, terma të lexuar gazetë, por këtu ka edhe to terma që janë në formë poezie, të lexohet në mënyrë të veçantë neni 12, 13, 14, neni 6, gjithçka është ndesh me njëri - tjetrin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Zemaj!
Tani e ka radhën zotëri Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Respekte, zotëri kryesues!
Zëvendëskryeministër,
Deputetë të nderuar,

Kolegët e nderuar deputetë, që morën pjesë në vlerësimin kritik, mendoj se i dhanë thekset krejtësisht të qëndrueshme, nuk do t'i përsëris. Prandaj, ky dokument do të duhej pa tjetër të ripërpunohet në çdo aspekt të gdhendet, t'i jepet toni juridik, se është ligj, është akt legal ju lutem, kjo është, një.

Dy, te definicioni apo nocioni, te përkufizimi, sponsorizimi del kontradiktor, sepse thuhet ndër të tjera se sponsorimi është marrëdhënie biznesore. Në anglisht thotë sponsorship is

same tim biznes relationship. Në serbisht, boshnjakisht, sponzorstvo je istovremeno biznisni odnos. Përkthimi është i dobët, “privredni” duhet të thuhet. Marrëdhënia apo raporti juridik biznesor është raport, marrëdhënie, relacion ndërmjet etniteteve biznesore për qëllime përfitabile, a del këtu në kundërshtim krejtësisht, do me thanë, aq më parë kur angazhohet që të rregullohet me kontratë, e tjera, e tjera.

Neni 15, ky nen duhet natyrisht të riformulohet krejtësisht, sepse është në kundërshtim me Rezolutën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për zgjidhjet e konflikteve, që është një dokument juridik, valid, aplikativ, ndërkombëtar, krejtësisht i njohur dhe duhet të harmonizohet me te, dhe ndër të tjera duhet të thuhet ..., do me thënë, në pika të shkurtra.

Konflikti ndërmjet kontraktorëve do të zgjidhej fillimisht, nëpërmjet vetë kontraktorëve me marrëveshje, po qe se ka mundësi. Nëse do të dështonte me ndërmjetësim, që e kemi këtu një dokument që do të shqyrtohej pas këtij apo pas dokumentit tjetër në shqyrtim. Më pastaj do të duhej që me arbitrazh, arbitrazhi medoemos, aq më parë kur këtu në këtë dokument inkludohen edhe subjektet biznesore të jashtme. Prandaj, jo gjykata, se te gjykata paraqiten probleme, a gjykata e vendit të sponzoruesit, apo gjykata e Kosovës, apo eventualisht një gjykatë tjetër. Kjo është një procedurë mjaft e ndërlikuar e që në ligj nuk është menduar fare për këtë.

Ndërsa, arbitrazhi zakonisht është një institut, apo një gjykatë, ta quajmë kushtimisht private, që aplikohet në praktikën bashkëkohore në kontestet e këtilla. Gjithsesi, këto që i thanë kolegët sa i përket gjuhës, sa i përket terminologjisë juridike, do të ishte tepër për të folur. Këto dokumente janë tepër të dobëta, numri më i madh i tyre. Nuk e di, këtu do të duhej Qeveria të merrej tepër seriozisht me këtë problem, se çdo dokument që na vjen, vjen me defekte të mëdha.

Dhe, përfundimisht, ju lutem, neni 16, po e zëmë, ta lexojmë në gjuhën shqipe, në anglisht edhe në serbisht. Ka, do me thënë, krejtësisht e kundërta, e kundërta, e kundërta, e është fjala për një ligj, është fjala për një rend juridik unik, se ndryshe do të paraqiteshin divergjenca me pasoja shumë të padëshirueshme gjatë aplikimit të tij në praktikë.

Edhe çështja e tatimit, e taksave, është një çështje e pro et kontra. Më të parën herë duhet të rregullohet kjo në mënyrë koncize dhe precize, sepse ekziston mundësia e bazuar që sponzoruesi vetë ta krijojë, ta themelojë, ta establishtojë një partnership apo një kompani që do të merrej me aktivitete të kulturës, e tjera, e tjera dhe bën pastrim të parasë. Kjo është metodë shumë elegante, pra edhe krejtësisht antiligjore. Kjo çështje do të duhej të rregullohej në mënyrë origjinale. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit zotëri Smaka!
Radhën e ka zotëri Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

I nderuari zoti kryesues,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar anëtarë të Qeverisë së Kosovës,

Po shihet qartë se identifikimi i problemeve në fushën e sponzorimeve në kulturë, rini dhe sport është evident, dhe ne këtu në Kuvend mund të diskutojmë për normimin e zgjidhjeve të këtyre problemeve. Por, nga mendimi, nga këndvështrimi im, nuk do të ishte e tolerueshme të diskutojmë për teknikat e hartimeve të ligjeve. Momentalisht Qeveria e Kosovës punon me një Rregullore në cilën qartë dhe saktë determinohet cikli i krijimit të ligjit deri në momentin e fundit të ardhjes së tij në Kuvend të Kosovës.

Për mendimin tim, dhe për mendimin besoj të të gjithëve, është pak sa fyese që të vinë ligjet që nuk i plotësojnë kushtet themelore të teknikave të hartimit të ligjeve, kur kihet parasysh se leximi i fundit në këtë cikël të tërë bëhet nga ministri. Mund të themi, siç na ka ndodhur edhe herëve të tjera, se ministri nuk e ka lexuar ligjin, por ky do të ishte gabim dy fish më i madh, sepse është nënshkruar mbi bazën e atij dokumenti. Kur kihet parasysh gjithashtu se në këtë cikël të hartimit të ligjeve ekziston edhe zyra për shërbime dhe ndihmë juridike, zyra për përkthime, zyra për standardizim, kjo krejt na lenë të kuptohet se ka mungesë të kapaciteteve në ato zyra dhe në ata resorë.

Ju lutem, që në të ardhmen diskutimet në Kuvend nuk ka arsye që të jenë të orientuara nga teknika themelore e hartimit të ligjeve, po mund të diskutojmë për gjetje të zgjidhjes së problemit si me këtë rast, siç është Ligji për sponsorizim, apo edhe ligjet e tjera. Mua edhe ju të tjerëve ju kujtohet shumë qartë kur i kthehet ligji Ministrisë së Drejtësisë për teknika të hartimit të ligjeve, kur ne e dimë se me Ligj të financave publike Ministria e Drejtësisë është avokate e interesit publik në rast kontesti me ndonjë interes individual, ku mund t'i besojmë ne atëherë Ministrisë së Drejtësisë në nivel profesional të mbrojtjes së interesit publik. Do ta rrumbullakoj me këtë që të kushtojmë më shumë kujdes në probleme administrative dhe teknike në ciklin në tërë të hartimit të legjislacionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rrustemi!

Duke qenë se nuk kemi në listë deputetë ose deputete të tjera të paraqitura, atëherë kërkojmë nga deputetët që të deklarohen për miratimin, në parim, të këtij projektligji. Të bëhen gati për t'u deklaruar dhe lus regjinë që të jetë e gatshme që tani. Votojmë tash:

Ju informoj për rezultatin e votimit. Nga 81 deputetë të pranishëm në sallë,

61 janë "për" 3 "kundër" dhe 7 abstenime.

Në këtë mënyrë, konkludojmë se ky Projektligj është miratuar, në parim.

Dhe, tani, më lejoni t'ju them se në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si komisioni funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,

3. Komisioni për Buxhet dhe Financa,
4. Komisioni për Komunitete, dhe
5. Komisioni për Integritet Evropian.

Kërkohet nga komisionet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Më lejoni tani që të shkojmë me tutje me pikat e rendit të ditës, konkretisht te:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim. Duke qenë se e kemi ministrin për Kulturë, Rini dhe Sport, zotëri Skender Hysenin, e ftojme që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

Mirëpo, me gjasë, do ta kemi kënaqësinë që përsëri ta kemi këtu zonjën Lirije Kajtazi, për kënaqësinë e të gjithëve, edhe të profesorit.

LIRIJE KAJTAZI: Ju faleminderit, të nderuar deputetë, për qasjen serioze dhe shprehjen e disponimit të mirë edhe për Projektligjin e parë! Tani do ta prezantoj shkurt edhe Projektligjin për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe të ansambleve të tjera.

Me synim që të rregullohet themelimi, vazhdimësia, puna, organizimi, veprimtaria dhe funksionimi i Ansamblit të këngëve dhe valleve “Shota” përgatitet Projektligji për Ansamblin, në vijim: Projektligji.

Projektligji hartohet në konformitet me standardet juridike bashkëkohore dhe me rrethanat vendore, për çka konsiderohet si një dokument juridik valid për t'u trajtuar në procedurë të rregullt për miratim.

Me këtë Projektligj në mënyrë të qartë sistematike dhe bashkërenditur është normuar statusi juridik i Ansamblit kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota”, themelimi përkatësisht vazhdimi i punës dhe i veprimtarisë së tij, rregullimi dhe organizimi i brendshëm i ansamblit, udhëheqja, drejtimi, statusi dhe të drejtat e punëtorëve, po ashtu çështje e tjera të rëndësishme lidhur me veprimtarinë e ansamblit.

Në Projektligj është koncipuar edhe Bordi Drejtues si dhe Këshilli Artistik i Ansamblit. Kaptinë e veçantë me këtë ligj do t'i referohet organizimit të brendshëm dhe funksionimit të Ansamblit përgjithësisht.

Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota”, si institucion me rëndësi të veçantë, mbrohet me ligj. Ky institucion mbështetet me buxhet nga themeluesi me obligim të sigurimit të kushteve optimale për punë si dhe të lokale përkatëse për zhvillimin e

aktivitetit, te i cili, me veprimtarinë e vet Ansambli mund të zgjerojë edhe më tutje bazën materiale financiare.

Projektligji në fjalë është më se i domosdoshëm për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, artistike brenda dhe jashtë Kosovës. Ai nuk prek interesat e asnjë nacionaliteti apo minoriteti.

Me këtë Projektligj përcaktohen parimet dhe rregullat themelore mbi krijimin e këtij Ansambli, po ashtu përcaktohen detyrimet dhe përgjegjësitë e institucionit për sigurimin e kushteve, të masave për mbrojtjen, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e këtij institucioni.

Politika e zhvillimeve kulturore artistike në të ardhmen në Kosovë do të mbështetet në këtë ligj, në aktet nënligjore që do të dalin më vonë nga ky Ligj dhe në dispozitat ligjore në vijimësi.

Drafti i parë i këtij Projektligji është iu është nënshtruar procedurave të nevojshme, ju sigurisht për këtë jeni të njoftuar, ku kanë qenë të kyçur edhe ekspertë nga lëmit përkatëse.

Konform programit të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve të saja për hartimin e legjislacionit përkatës, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit konform planit legjislativ të Departamentit Ligjor të Ministrisë sponsorizon Projektligjin për Ansamblin “Shota” dhe parashikon përfundimin e të njëjtit, i cili është proceduar më herët në Qeveri dhe tani është në duart tuaja.

Të nderuar deputetë,

Jemi përpjekur të bëjmë një prezantim të shkurtër. Ju e keni Ligjin në duart tuaja, me kontributet edhe të mëhershme, edhe në vazhdim. Unë ju ftoj që ta miratoni në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kajtazi!

Pas këtij prezantimi, i ftoj kryetarët e grupeve parlamentare ose të autorizuarit nga shefat e grupeve, që ta marrin fjalën. Drita Kadriu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër dhe zëvendëskryeministër,
Kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar, në parim, Projektligjin për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera. Konsiderojmë se hartuesi i këtij Projektligji me rastin e përpilimit ka bërë disa lëshime të karakterit teknik dhe gjuhësor, që shpesh japin dykuptimësi të çështjes që e mbulon. Për shembull, neni 8.1, 8.2, pastaj këto vërehen edhe te neni 9 dhe 10. Gjithashtu janë identifikuar edhe problemet përmbajtjesore, si në titujt e kapitujve, ashtu edhe në përmbajtjen e disa neneve, si te neni 3, neni 5 e në disa nene të tjera.

Më lejoni t'ju paraqes gjithashtu se ky Projektligj ka deklaratën financiare deri në vitin 2009 dhe ka implikime buxhetore.

Gjithashtu, Projektligji ka pajtueshmërinë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Me qenë se këto vërejtje janë të modifikueshme dhe ka mundësi që komisioni funksional përgjegjës raportues t'i modifikojë në leximin e dytë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës jep pëlqimin që ky Projektligj të aprovohet në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit edhe juve!

Tani radhën e ka Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotëri Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Meqë më ftove, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, arsyet për mbështetje në parim do t'i japë zonja Berisha, deputete nga radhët tona, por meqë m'u dha rasti, zoti Kryesues, të lutem ftoje zëvendësministren Kajtazi të marrë vendin në radhën e ministrave, sepse me ligj ajo ushtron detyrën e ministrit të Kulturës dhe në mungesë fizike të ministrit gjithmonë ajo përfaqëson dhe në çdo vend demokratik, me çdo rregull ajo e merr edhe ulësen, edhe detyrën, edhe ushtrimin e kompetencave. Në këtë rast, është praktike të ftohet nga Kryesuesi ta merr ajo vendin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Haziri, por administrata e Kuvendit nuk ka njoftime të caktuara, për ndryshe për kënaqësinë time menjëherë do ta zbatoj, po nuk guxoj të shkoj më tutje. Sidoqoftë, mua më solle në dilema me t'ia jap fjalën edhe zonjës Fatmire Berisha. Atëherë, do të bëjmë një përjashtim, po kërkoj falje prej të tjerëve, zonja Berisha.

FATMIRE BERISHA: I nderuari kryesues,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Ministra të nderuar,
E nderuara zëvendësministre.

Ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar Projektligjin e Ansamblit kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota" si dhe të ansambleve të tjera dhe në parim ne e mbështesim këtë Projektligj. Ndërsa, në të ardhmen, pas miratimit të tij në parim, do japim kontributin tonë në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit e juve zonja Berisha!
Në radhë është zotëri Esat Brajshori, në emër të AKR-së.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për dallim nga Projektligji që u votua tani, rezervat tona në drejtim të këtij Projektligji që e kemi përpara për Ansamblin “Shota” dhe ansamblet e tjera, janë rezerva shumë të mëdha.

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar Projektligjin për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe të ansamble të tjera. Me këtë rast ka gjetur shumë mangësi, paqartësi në kuptimin e definimit të qartë të neneve të caktuara për fusha të caktuara.

Kemi nenin 17.3 për kandidat për drejtor apo drejtor artistik jep të drejtën e rizgjedhjes, por nuk përcakton se sa mandate rizgjedhet.

Kemi nenin 3.4, nenin 6.3, ku thuhet: “Ansambli “Shota” harton dhe propozon planet dhe programet vjetore të punës, të veprimtarisë për realizimin e programeve dhe të shfaqjeve”, por nuk thotë se kush i miraton planet dhe programet vjetore të këtij Ansambli.

Bile, diku e kemi që edhe Qeveria mund të krijojë ansamble! E çuditshme kur është Ministria e Kulturës e thirrur për këto gjëra. Ka plot defekte të shembujve që i thamë më lart. Por, për të kaluar në leximin, në shqyrtimin e dytë, duhet komisionet gjegjëse të bëjnë shumë punë derisa Grupi Parlamentar i AKR-së do të japë kontributin e vet. Prandaj, në parim e përkrahim këtë Projektligj, po them, me lëshime shumë të mëdha. Nuk po ndalem në anën teknike, siç u ndalëm pak më herët te Projektligji i parë, por konsiderojmë të debatohet mbi esencën e çështjeve, se edhe në atë fushë ka shumë për të thënë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Brajshori!

Në radhë është zotëri Naim Maloku, unë po supozoj që ne emër të Grupit Parlamentar.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Në Grupin Parlamentar të AAK-së mbizotërojnë dilema se a është dashur fare të nxirret një ligj i tillë për Ansamblin “Shota” dhe ansamble të tjera, por me qenë se e kemi përpara dhe në shqyrtim, nuk dua t’i përsërisë mangësitë që parafolësit e mi i thanë për këtë Projektligj. Ne si Grup Parlamentar do të marrim pjesë në votim dhe në shqyrtim në procedurën e mëtejshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Maloku!

Në radhë është zotëri Naser Rugova.

NASER RGOVA: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Anëtar të Kabinetit qeveritar,

Të çmuar kolegë deputetë,

U bë temë dite a të ulet zëvendësministri apo ushtruesja e detyrës të ministrit në rend me anëtarët e Kabinetit qeveritar, apo jo. Ju lutem, na këtu e kemi ministrin që është nominuar për në dikaster tjetër qeveritar, por që është ende ministër i Kulturës dhe

ende nuk e kemi zgjedhur, do të thotë, as ministrin e Punëve të Jashtme, as ministrin e Kulturës, që po ashtu është nominuar dhe. Kërkoj që të respektohen procedurat parlamentare konform Rregullores së Punës së Kuvendit.

Lidhja Demokratike e Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për Ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera.

Projektligji në fjalë nuk ka ndonjë lidhshmëri me *acquis communautaire*, prandaj mund të thuhet se Projektligji nuk cenon legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Është mirë, më në fund, që kjo fushë e kulturës në Kosovë po rregullohet me ligj, edhe pse ka lëshime dhe defekte serioze. I mbetet komisionit funksional dhe grupit të ekspertëve që të punojnë shumë në pothuaj se 80% të neneve të këtij Projektligji.

Te deklarata financiare janë disa paqartësi që ndërlidhen me organet kolegjiale të Ansamblit “Shota”, si Këshillit Drejtues dhe atij Artistik që është e nevojshme të rregullohen me akte nënligjore. Po ashtu, Komisioni funksional i Kuvendit duhet ta ketë parasysh këtë.

Ne, si Grup Parlamentar e përkrahim në parim këtë Projektligj dhe vërejtjet dhe sugjerimet tona eventuale do t’i japim gjatë procedurave të amendimit të mëtejshëm të këtij Projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Rugova!
Në radhë është Myfera Shinik nga Grupi “7+”.

MYFERA SHINIK: Ju faleminderit!

Şota ve diğer milli şarkı ve diğer halk dansları toplulukları Yasa Tasarısının birinci okunuşunu 7+ Parlamenter grubu olarak prensipte kabul ediyoruz. Ancak diğer toplulukların beklentileriyle ilgili tekliflerimizi Fonksiyonel Komisyonuna sunacağımızı gözönünde bulundurulmasını arz ediyoruz. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Shinik!
Përfaqësuesi i Grupit SLS, zotëri Stojanović!

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani gospodine predsjedavajući,
Poštovane kolege,

Mi smo razmotrili ovaj Zakon i meni nije baš u potpunosti jasno šta on treba tačno da obuhvata.

Ja mislim da smo ovde suštinski pomešali neke stvari. Formiranje i osnivanje, to jest naslov Ansambla „Şota“, koji se ovede naziva Nacionalni ansambl „Şota“, to u načelu možemo da podržimo i slažemo se da treba formirati. Međutim, ne vidim nikakvu vezu, šta ima sa tim ostali naslov zakona o drugim ansamblima. Drugi ansambl na Kosovu ne postoje. Nigde ovde ne piše dali neko ima prava, dali neko ima nameru da

formira druge ansamble. To što se ovde pokušava podvesti pod ansamble ne predstavljaju ansambli, već predstavljaju kulturna umetnička društva, koja nema angažovane profesionalne radnike.

Jako bitna stvar po sve zajednice da čuvaju izvornost i tradiciju, ono što daje identitet svakom narodu. Međutim, da je ovo vezano sa zakonom o regulisanju amaterizma, znači nešto što je vezano za savez ametera, meni bi bilo prihvatljivo. Ali ovde spominjemo radnike, spominjemo umetničke rukovodioce, spominjemo odbore, meni stvarno nije jasno. Mi ćemo morati još da radimo na ovome. Naravno, mi ovakav Zakon ne možemo da podržimo jer ja ne vidim šta je poenta drugog dela zakona, a ono što je vezano sa Ansamblom „Šota“ jasno mi je.

Ovde ima članova gde se kaže: čuvanje, gajenje i prezentacija nacionalnih kulturnih tradicija gradjana koji žive van zemlje. Zamislite, vi predvidjate da neki gradjanin Kosova koji ode u Norvešku da može ovde da se vrati kroz Ansambal „Šota“ da prezentuje norvešku kulturu ili nije bitno kuluturu koje zemlje, a druge zajednice uopšte nisu obuhvaćene. Da li taj ansambal predstavlja nacionalni ansambal samo Albanaca. I ako to treba da postoji, ja se slažem, i mi ćemo podržati to, ali tražim da se ovde unese kako ćemo regulisati ostale ansamble.

Šta je sa ostalim zajednicama? Ja mogu da kažem da Kosovo ima Srpsku zajednicu koja živi na ovoj teritoriji, ima 7 različitih etnografskih zona. Treća stvar, i oko samog Ansambala. Ansambal ovde predvidja da u Upravnom odboru ima jednog člana iz skupštine opštine. Nacionalni ansambal nije vezan za nijednu opštinu, vezan je za Vladu ili za Ministarstvo kulture koja ga formira. Nema uopšte, na primer priče da neki iz Akademije i nauka učestvuje u tom Umetničkom odboru, jer moraju tu da rade vrhunski profesionalci. Nema etnomuzikologa, nema etnografa. Ovakav zakon, ovaj predlog što smo dobili, znači na prvom čitanju poslanici Samostalne Liberalne stranke će ostati uzdržani i mi ćemo kroz funskionalne komisije tražiti da se mnoge stvari ovde izmenjuju, mada mislim da će ovo biti nešto što je neizvodljivo, jer ovde stoje dva zakona koja nemaju veze jedan sa drugim, o nacionalnom ansambu i ostalim ansamblima, o kategoriji koja ne postoji. Postoje, ako mi imamo nameru da registrujemo ostale ansamble i onda ćemo da ih podvedemo pod posebnim odredbama Zakona, ili postoji novi zakon o regulisanju ametarizma koji se dešava na ovim prostorima. Ovo zajedno, ove dve stvari zajedno ne idu nikako. Hvala vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Stojanoviq!

Me të mbaruar fjalën përfaqësuesit e grupeve parlamentare, shkojmë te lista e atyre që janë paraqitur për të marrë fjalë, deputetëve, deputeteve dhe në këtë listë në radhë është zotëri Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, kryesues!

Njeriu që diskutoi para meje i ka hetuar do probleme. Ashiqare, kemi një ligj që në thelb është ligj për Ansamblin “Shota”, që e ka një traditë dhe që shumica e dinë çka ka punuar ai dhe çka pretendohet të punohet, dhe ansamble të tjera, duke u përpjekur që të krijohet një kodifikim i mundësisë së formimit të tyre, por jo të amatorizmit tash, se

problemi është shumë i ngarkuar. Nuk mund të ketë amatorizëm që financohet nga shteti. Duhet të shihet neni 8.

Unë po e lë këtë problem, unë dua ta shoh ligjin. Ky Ligj për “Shotën” është pak a shumë si shumë ligje, të cilat ne edhe në legjislaturat e tjera jemi përpjekur t’i modernizojmë dhe t’i kodifikojmë situatat që i kemi. Pra, ka qenë sigurisht për Ministrinë dhe për Qeverinë një problem i veçantë çka të bëhet me “Shotën”, një pikëpyetje e madhe dhe kanë vendosur që ta krijojnë një ligj për ta bërë ligjërisht “Shotën” ansambël nacional, që i bie shtetëror, se ka interpretime. Kjo është, unë e kuptoj në atë kuptim, nacional si ansambël shtetëror, i cili financohet tërësisht nga buxheti. Mirëpo, ajo që mua më bën përshtypje dhe që më duket që ka një mospërputhje të kriterëve të ndërtimit të vetë ligjit dhe të vetë funksioneve “Shotës” si ansambël, është nëse krahasohen tri nenet e para.

Neni 1, përcakton: “Veprimtaria e Ansamblit “Shota” ushtrohet në mënyrë publike”.

Neni 2, thotë: “Veprimtaria e Ansamblit “Shota” përfshinë:

- a) përgatitjen;
- b) organizimin, dhe
- c) shfaqjen publike të koncerteve dhe të formave të tjera skeniko-muzikore”.

Kjo i bie përshkrim historik i veprimtarisë së Ansamblit “Shota”. Mirëpo, neni 3, që përshkruan se çka do të bëjë “Shota”, kjo është e pamundur që ta bëjë një ansambël me formatin që e ka “Shota” sot, ose që i përshkruhet në nenet tjera. Pse? Sepse i shtrohen kushte që do të mund t’i bënte një institut etno-muzikologjik, një institut i folklorit etj., por formati dhe përbërja që përshkruhet e “Shotës” në gjithë ligjin, shans nuk ka t’i bëjë këto punë dhe unë po them, veç po sugjeroj, për shembull, neni 3 a,b,k e tjera. Këto të tria i përmenda, pra do të duhej e gjithë përbërja, strukturimi i “Shotës” të bëhet ndryshe për t’i kryer këto funksione.

Meqë unë, nuk besoj që ndodhë kjo, atëherë në përpunimin e dytë të shikohet neni 8, thashë që ka të bëjë me financimin, se duhet të përkufizohet çfarë madhësie do të jetë ai ansambël. Nëse shteti merr me ligj të drejtën ose detyrimin e financimit, duhet për t’i ketë përmasat ku shkon diku, sa janë ata ose sa mund të bëhen, që nuk ekziston përshkrimi në ligj. Dhe, e dyta, të mos i vishen detyra që, ju garantoj që s’ mund t’i bëjnë.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hamiti! Në radhë është Hydajet Hyseni Kaloshi.

HYDAJET HYSENI KALOSHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Duke përshëndetur edhe këtë nismë ligjvënëse, unë dua ta vazhdoj aty ku e lanë parafolësit. Është e vërtetë dhe, duke përsëritur diçka që u theksua me të drejtë, ky ligj përveç vërejtjeve tjera që mund t’i bëhen, është e vërtetë që e ka ngatërruar çështjen, duke mëtuar që të rregullojë me të njëjtat dispozita edhe statusin e Ansamblit “Shota”,

që është një ansambël i veçantë në Kosovë, sido që të trajtohet, dhe të ansambleve të tjera. Prandaj, mendoj që kjo çështje duhet rregulluar.

Zoti Hamiti i përmendi nenet 1 e 2, unë do të theksoja veçanërisht nenet 3 dhe 4, që vështirë inkorporohen me nenet 1 dhe 2. Për më tepër, neni 9, ta zëmë, në titull ka kujdesin e ansambleve për dokumentacionin, e tjera, të ansambleve në shumës, kurse brenda dispozitat vijuese ekskluzivisht flasin për “Shotën.” Nuk mund të zbatohet ligji në këtë mënyrë.

Unë mendoj që nuk mund të ketë, siç tha edhe parafolësi përpara, të njëjtin kut për Ansamblin “Shota” që është një ansambël kombëtar në Kosovë, në kuptimin shtetëror, nacional dhe gjithëpërfshirës, dhe për ansamblet e tjera amatore, regjionale etj. Prandaj, ligji ose duhet të jetë ligj për “Shotën” dhe të mbetet këtu, ose të jetë Ligj për ansamblet muzikore dhe ta rregullojë në tërësi.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni!

Unë besoj se do ta kem pajtimin e deputetëve që t’ia japim mundësinë zotëri Hamitit. Regjia, zotëri Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: E lash herën tjetër, pra. Shkurt e harrova, ta përmend nenin 37-Kushtet dhe kriteret e veçanta. Neni me 2-3 paragrafë ka të bëjë me pensionimin e njerëzve që merren me këtë veprimtari, duke pasur parasysh si veprimtari të sojit të veçantë.

Unë, mendoj që kjo ka pasur të bëjë me cilësimin e një tipi veprimtarie që lidhet me një moshë, me një kohë, e të tjera. Por, unë mendoj që neni 37, kështu si është me të tri nenet, nuk duhet të ekzistoj në këtë ligj hiq, sepse këto rregullohen me Ligjin për pensionet. Nuk ka shans veprimtaritë e veçanta, prej rasti në rast të kodifikohen nëpër ligje, siç ka ndodhur këtu. Shkurt, mendoj që kjo është tepër këtu. Kaq.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Hamiti!

Zotëri Riza Smaka e ka fjalën. Po ju kërkoj falje që keni pritur pak më shumë sesa që duhet.

RIZA SMAKA: I nderuar kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra dhe deputetë të respektuar,

Ju lutem, vetëm ta lexoj shkurtimisht paragrafin 2, të nenit 1, i cili thotë: Me këtë ligj, në veçanti, në veçanti do të thotë rregullohet, se nuk rregullohet, po përcaktohet, themelimi, përkatësisht vazhdimi, që janë në kolizion njëra me tjetrën. Themelimi, vazhdimi s’mund të përcaktohet me ligj. Vazhdimi është, domethënë funksionimi, e tjera, e tjera. Ose paragrafi b) Rregullimi dhe organizimi i brendshëm i ansamblit. Kjo është tematikë e statutit, e statutin do të duhej ta miratonte “Shota” nëpërmjet organit të autorizuar, e statutin do të duhej ta konfirmonte Qeveria, sepse buxheti e financon. Domethënë këto janë disa vërejtje substanciale, ju lutem.

Më pastaj, neni 7, paragrafi 2: “Ansambli “Shota” ka simbolet e veta identifikuese, institucionale dhe artistike, si stemat, shenjat identifikuese etj. etj.” Po qysh mund të shkruhet në ligj etj., etj. Po kjo është qesharake, është irituese. Edhe kjo tematikë, ju lutem, do të duhej të amendohej dhe të jetë: “të cilat përcaktohen me statut”, ju lutem , me statut, ato përcaktohen me statut.

Më pastaj neni 8, paragrafët 1 e 2. Shih çfarë formulimi, thotë: “Mjetet financiare për zhvillim normal, efikas”. Terminologji e referateve, si me thënë kështu, apo e mitingjeve, dhe “të suksesshëm etj., etj., siguron themeluesi”, në vend që të thuhet: “Ansambli “Shota” financohet nga buxheti i Kosovës”. E se a do të jetë efikas, a do të jetë eficient, a s’ do të jetë, aty ajo është tematikë krejt tjetër, ju lutem.

Më pastaj, ja ku është dispozita tjetër ku e rregullon këtë krejt ndryshe, të njëjtën materie, neni 41: “Me mjete nga buxheti i Kosovës sigurohet: puna, veprimtaria e ansamblit, puna e organeve të tij, të qeverisjes, bashkëpunimi ndërkombëtar, blerja, pastrimi, pasurimi i kostumeve, instrumenteve etj.” Domethënë një deskripcion totalisht jashtë kontestit ligjor, madje edhe rregullativ.

Kolegët thanë, unë nuk do t’i përsëris me respekte. Tani për tani kaq.
Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në radhë është zoti Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Ovako, ja bih samo još kratko, neke stvari sam možda propustio, ali i nakon mog izlaganja ovde smo čuli jednu priču. Ja opet ponavljam, ja stvarno i moja Poslanička grupa nemamo ništa protiv da se osnuje nacionalni ansambal, ali ne možemo pod nacionalni da sprovodimo i da ga zovemo nacionalni u jednom kontekstu, u drugom da ga zovemo državni. Zamislite da na koncert pozovete gospodidna Ahtisarija i kažete, evo to je nacionalni ansambal, a u njemu se izvode igre i pesme i učestvuju u radu samo pripadnici albanske zajednice. Ja se slažem da se oformi Nacionalni ansambal, koga će da plaća Vlada i koji će da predstavlja samo ono što je tradicija, izvornost i kultura Albanske zajednice, ali kako ćemo da definišemo ostale oblasti.

Ovde imamo i kod člana, gde kaže: „Ansambli su muzičke grupe, odnosno kulturno - umetničko društvo“. Ili su muzičke grupe, ili kulturno - umetnička društva, pa onda ih organizavamo u tome šta ansambali mogu da rade. Oni za cilj ostvarivanja kulturnih aktivnosti izraženih pesmom, igrom i koreografijom. Ne mogu ansambli da se bave samo pesmom, igrom i koreografijom. Ima i običaje, imaju i složene muzičko-scenske nastupe. Verujte mi, ja se malo bavim tom oblasti već duži niz godina i poznajem to dobro. Ja mislim da bi najbolje bilo da Ministarstvo za kulturu još jednom razmotri ceo ovaj Zakon, može da ga povuče privremeno pa da ga doradjenog pošalje ovde, lakše bi došli do procedure usvajanja. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Stojanoviq!
Tani e ka fjalën zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në të vërtetë këtu shihet qartazi, kjo më shumë do të jetë çështje e ekspertëve që të ketë ndërhyrje në këtë projektligj. Sigurisht do ta kërkojnë anëtarët nga Komisioni funksional, po, patjetër duhet ndalem te disa nene këtu, mos të them vazhdimësi aty ku e la profesor Hamiti, te neni 4, neni 5. Neni 5, veprimtaria e Ansambilit “Shota”, pjesëmarrës në hartimin e politikës strategjike mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore, një. E dyta, te mëvetësia, prapë atje më herët e kemi Kuvendi, puls e kemi edhe Kuvendi i Kosovës themelon ansamble, çka për mua, ndoshta, është e pakuptimtë.

Te organizimi i brendshëm dhe funksionimi, po ta lexosh me vëmendje nuk e din kush do të jetë udhëheqës i saktë- drejtori, këshilli drejtues, këshilli artistik, sekretari. Është shumë, shumë komplikuese, sidomos te neni 26 në të mirë të Ansambilit – Këshilli artistik, domethënë në të mirë të ansambilit, jo nuk e detyron, Këshilli artistik bashkëpunon dhe bashkërendon me këshillin drejtues, me drejtorin dhe me institucionet tjera simotra në Kosovë dhe jashtë saj, si dhe me të gjithë punonjësit e ansambilit. Konkretisht nuk e rregullon këtë çështje. Ndërsa, tjetra është te neni 36 -vlerësimi për të arriturat e veçanta dhe kulmore. Këtu njerëzit mund të avancohen, në çka, drejtorë të Ansambilit, këshill artistik, aty nuk ka përkufizime. Prandaj, me të vërtetë duhet të shikohet me vëmendje dhe këto vërejtje t’i kenë parasysh sidomos te Komisioni Funksional.

KRYESUESI: A mund t’ju them faleminderit. A mbarove? Ju faleminderit shumë.
Në radhë është zoti Adem Hajdaraj

ADEM HAJDARAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të gjithëve,

Unë desha vetëm në një pikë të ndalem, çështja e titullit të kësaj, më duket se nuk është në rregull. Nuk mund të veçohet në titull “Shota” dhe të tjerat dhe pajtohem me diskutimin e Hydajet Hysenit, që tha: “ose duhet të jetë Ligji për Ansamblin Kulturo-artistik “Shota”, ndërsa një ligj tjetër për të tjerat ose për ansamblet kulturo- artistike”. Më duket se është shumë më e drejtë, domethënë, të jetë kështu dhe, megjithëse unë do ta tumirë kështu, në parim, besoj që këtu duhet të kemi kujdes. Nuk bën të thuhet kurrsesi “Shota” dhe, ose Adem Hajdaraj dhe të gjithë të tjerët, por duhet të caktohet për Ansamblin “Shota” ose për të gjithë së bashku, pavarësisht që e theksuan që është nacional etj. etj. Nacional do të ishte edhe atëherë kur do të thoshim për Ansamblin “Shota”, pa i marrë të tjerat.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hajdaraj!

I fundit në listën e kontribuuesve për këtë ligj është edhe zoti Bujar Bukoshi.

BUJAR BUKOSHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra, përkatësisht zëvendësministër,

Të nderuar kolege dhe kolege deputetë,
Pasi jam i fundit, atëherë, sigurisht që kontributi im do të jetë fare i vogël, por unë do të përpiqem vetëm t'ju përkujtoj ose të bëj një pledoaje, përkujdes në këtë temë shumë senzitive, që mund të bëhet sensitive edhe bazuar në përvojat e përparme, jo ato negative. Përvoja negative, për shembull kujtoj kur në vitet e 50-ta, gjatë Jugosllavisë së Titos, Jugosllavia e Titos pat përfutur shumë, ekstrem shumë me "Vallën e Rugovës" në vitet e 50-ta pat fituar vendin e parë aty në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose në Montren në festivalin e Motresë, kur Ansambli Shtetëror i Shqipërisë pat entuziazmuar jo vetëm opinionin shqiptar, jo vetëm shqiptarët e Shqipërisë po gjithandej dhe, po ashtu, aty mori pjesë edhe komponenta e Dropullit, për shembull minoritetit grek. Me këtë duhet të përpiqem të zvogëloj atë frikën, domethënë ato reminishencat e sistemeve të kaluara se Kosova nuk i rrezikon pakicat kombëtare, nuk e rrezikon komunitetin serb, por, nëse kjo merr një trend tjetër, atëherë është rrezik që të krijojmë ansamble kombëtare të enklavave. Ansambli Kombëtar i Novo Bërdës, Ansambli Kombëtar i Graçanicës, i Mitrovicës së Veriut, të gjitha, do të degjeneronte puna. Por, tash unë nuk e di, le të punohet, të përkufizohet a është SHTAC, domethënë Ansambli Shtetëror ky. Nëse është Ansambël Kombëtar "Shota" i Kosovës, atëherë aty duhet të ketë edhe minoritete tjera ose bashkësi tjera. Për shembull "Shota", përveç valleve shqiptare të ketë edhe "Zhikino kollo" për shembull, domethënë të kemi kujdes se unë personalisht nuk e kam as atë siklet tash për të shpenzuar shumë energji, për ta bindur edhe kolegun Stojanoviq se nuk ka rrezik komuniteti serb në këtë pikëpamje, aq më tepër kur Kosova për momentin e ka të siguruar një mekanizëm më të mirë të Evropës Juglindore për mbrojtjen e minoriteteve. Kjo është akceptuar dhe pranohet edhe në Parlamentin Evropian.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Bukoshi!

Duke qenë se kanë mbaruar të gjitha paraqitjet këtu të deputetëve, atëherë ka ardhur çasti që të kërkojmë nga deputetët të deklarohen për miratim në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe juve të bëheni gati, tani

Ka mbaruar votimi. Ju njoftoj se nga 63 të pranishëm, 51 kanë votuar "për", një ka votuar "kundër" dhe 10 kanë "abstenuar".

Në këtë mënyrë mundemi të konstatojmë me kënaqësi dhe do të konstatojmë se është miratuar ky ligj në parim. Ju faleminderit!

Do të shkojmë edhe te komisionet funksionale dhe të tjerat që do të ngarkohen për të përpunuar më tutje dhe për të dhënë formën definitive këtij ligji. Në bazë të rregullave 23, pika 7 dhe 35, pika e katërt e Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sporte, si komision funksional dhe raportues,

2. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
3. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
4. Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe
5. Komisionin për Integritet Evropian.

Këto komisione brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit duhet t'i paraqesin Raportin me rekomandime. Ju faleminderit!

Shkojmë te pika tjetër e rendit të ditës së kësaj seance, që është në fakt

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim

Duke qenë se ky projektligj iu është shpërndarë deputetëve që përpara, konstatojmë se janë përmbushur kushtet për shqyrtimin në miratim të tij në parim. Së këndejmi me lejon të ftoj zotin Ramë Manaj, në mungesë të zonjës Kelmendi, që në emër të Qeverisë të Kosovës, t'ia paraqesë Kuvendit Projektligjin.

RAMË MANAJ: I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Unë kam nderin që në emër të Ministrisë së Drejtësisë dhe natyrisht të Qeverisë së Kosovës, para jush të paraqes një arsyeshmëri të shkurtër të Projektligjit për ndërmjetësim.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe natyrisht kontribut i angazhimit të përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj.

Në gjendjen delikate nëpër të cilën ka kaluar sistemi i drejtësisë jemi ballafaquar, pa dyshim, me vështirësitë të shumta të gjyqësorit për zgjidhjen e problemeve, po ashtu të shumta.

Inkorporimi i institutit të ndërmjetësimit në sistemin e drejtësisë do të bëjë të mundur shtimin e efikasitetit të gjykatave dhe të prokurorive, si dhe do të ndikojë në thjeshtësimin e procedurës, natyrisht edhe përshpejtimin e saj dhe në uljen e shpenzimeve procedurale.

Projektligji për ndërmjetësimin paraqet jo vetëm një masë ndihmëse, por një domosdoshmëri, si për faktin se fut një institut të ri dhe modern në praktikën tani të proklamuar, por edhe për faktin se ky ligj është ndërhyrje komplementare e fuqishme në përmirësimin e gjendjes së sistemit gjyqësor dhe stimulimin e konceptioneve të reja për zgjidhjen alternative të çështjeve të ndryshme të karakterit juridiko- civil dhe penal, të cilin institut juridik sot e kanë akceptuar pjesa dërmuese e vendeve të zhvilluar dhe e atyre në tranzicion.

Ndërmjetësimi ka rëndësi shumë të madhe, pasi që me futjen e këtij instituti të ri në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, do të arrihen qëllimet e shumta, e ndër më të

rëndësishmet është se do të ndikojnë në përshpejtimin e procedurës dhe natyrisht uljen e shpenzimeve procedurale.

Me këtë projektligj caktohen rregullat e procedurës të ndërmjetësimit në marrëdhëniet kontestuese, posaçërisht në raportet juridiko-pasurore të subjekteve të së drejtës tregtare, familjare, të punës, raportet tjera civile, administrative e penale, në të cilat palët lirisht mund të disponojnë me vullnet të lirë, pos që nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo e një organi tjetër kompetent.

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertët e shquar të Kosovës, duke përfshirë profesorë të Fakultetit të Drejtësisë: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, si dhe ekspertë ndërkombëtarë, të gjithë këta njohës të mirë të fushës civile dhe asaj penale.

Ky institut që përfshinë dhe rregullon ky projektligj, është alternativë shumë e rëndësishme e cila ndikon në lehtësimin e punës së gjykatave, prokurorive, organeve tjera. Nëse kjo procedurë tregohet e suksesshme, në të kundërtën do të zhvillohet shqyrtimi gjyqësor në paraqitjen e provave për argumentimin e fakteve relevante juridike në mënyrë të gjithanshme.

Inkorporimi i një instituti të këtillë, do të ndikojë në avancimin e legjislacionit në këtë fushë, me këtë edhe avancimin e të drejtave të palëve në procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme në një afat të arsyeshëm kohor, në pajtim me aktet juridike edhe ndërkombëtare.

Fuqizimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë, sepse do t'i hapë rrugë shtimit të efikasitetit në punën e gjyqësorit, gjë e cila do të ndikojë në uljen e numrit të lëndëve, si dhe do të ndikojë në shtimin e besimit të gjyqtarëve në gjykatat tona.

Ky projektligj rregullon në tërësi këtë fushë në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.

I nderuari zoti kryesues dhe të nderuar deputetë,

Fuqizimi i këtij projektligji, respektivisht përkrahja e tij është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë, andaj propozoj dhe ju ftoj që pas procedurave të shqyrtimit të tij, të miratohet në Kuvend dhe të shpallet, natyrisht për t'u implementuar pastaj.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit edhe juve!

Pas prezantimit të këtij projektligji, e hap debatin për diskutim në parim dhe shkojmë me radhë. Grupet parlamentare, përkatësisht përfaqësuesit e tyre e kanë radhën. Është paraqitur zonja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë, ju përshëndes të gjithëve

Projektligji për ndërmjetësimin hyn në grupin e ligjeve të rëndësishme në sistemin e drejtësisë.

Ligji i propozuar ofron mundësi për të krijuar metoda konkrete alternative të zgjidhjeve të kontesteve, si të fushës penale, civile dhe administrative. Qëllimi i këtij ligji është jo vetëm rregullimi dhe funksionimi i ndërmjetësimit si mënyrë alternative e zgjidhjes së kontesteve, por edhe rregullimi dhe krijimi i këshillit të ndërmjetësimit, kushtet e kërkuara nga Ministria e Drejtësisë, komisionet e ndërmjetësimit dhe certifikimi i ndërmjetësuesve, duke i dhënë ingerenca ekskluzive Ministrisë dhe ministrit të Drejtësisë.

Të nderuar deputetë,

Republika e Kosovës, për herë të parë, me ligj të veçantë e rregullon ndërmjetësimin si veprimtari jashtëgjyqësore. Ligji e konsideron ndërmjetësimin si veprimtari jashtëgjyqësore që realizohet nga personi i tillë- ndërmjetësi, për zgjidhje në pajtim të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës, personave fizik dhe juridik.

Ligji e pranon ndërmjetësimin e arritur në bazë të marrëveshjes jozyrtare të subjekteve të së drejtës, para fillimit të procedurës në një gjykatë konkrete kompetente.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, konsideron se zgjidhjet e propozuara në Projektligjin për ndërmjetësim, krijojnë mundësi ligjore që përmes alternativës së ndërmjetësimit të zgjidhen shumë konteste, të cilat në mënyrë më efikase dhe më me sukses në aspektin kohor dhe financiar dhe në përmirësimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore.

Sipas këtij ligji, Këshilli do t'i emërojë komisionet ad-hoc ndërmjetësimi të zgjedhur në mesin e anëtarëve të Këshillit. Projektligji përbën një hap përpara në pranimin e standardeve ndërkombëtare që rregullojnë mjetet alternative të zgjedhjes së konflikteve. Zbatimi i ndërmjetësimeve redukton numrin e rasteve në gjykatë, ekonomikisht është më i favorshëm për palët dhe buxhetin e Kosovës, si dhe me anë të ndërmjetësimit, palët sigurojnë marrëveshjen pa imponim në një periudhë të shkurtër kohore, duke garantuar edhe ruajtjen e fshehtësisë personale apo edhe asaj afariste.

Me miratimin e këtij projektligji, do të lehtësohet shumë puna e mbingarkuar e gjyqësorit në Kosovë. Marrë në përgjithësi, ligji përmban një teknikë të mirë juridike për rregullimin e materies së ndërmjetësimit për zgjidhjen e kontesteve të lartpërmendura.

Projektligji i propozuar është i qartë dhe konkret, për faktin se me këtë ligj nuk rregullohet procedura e ndërmjetësimit për të mitur dhe arbitrazhin, këto dy procedura janë të rregulluara me ligje të veçanta.

Në emrin tim dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, konsideroj se ligji mund të miratohet në shqyrtim të parë.

Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit zonja Dauti! Fjalën do ta marrë, zoti Kolë Berisha, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

KOLË BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Propozim ligjin për ndërmjetësimin dhe konsideron se për dallim nga shumë tekste tjera të mëparshme që ka pasur në shqyrtim dhe miratim, duket se me këtë propozim ligj, komisionet e Kuvendit nuk do të kenë shumë punë.

Propozim ligji ka një gjuhë të rrjedhshme, si në aspektin struktural dhe gjuhësor të shqipes, po ashtu edhe në aspektin juridik. Ka një shtrirje të mirë strukturale të lëndës, e ruan harmoninë ndërmjet neneve dhe kapitujve, është i qartë dhe i kapshëm si tekst për nivelet e ndryshme të gjitha palëve ndërgjyqësore ose ndërmjetësuese.

Grupi Parlamentar i LDK-së, mendon se me një ndërhyrje të lehtë mund ta kemi një ligj solid, prandaj propozon që të përkrahet në parim.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kolë! Fjalën e ka tani zoti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër dhe deputetë,

Ky ligj së pari nuk është domosdoshëm, përderisa me dispozita ligjore të gjitha procedurave civile, administrative, penale, tregtare, në aplikim ekziston një institut juridik i ndërmjetësimit. Domethënë nuk është asgjë e re, ka ekzistuar edhe shumë e shumë herët më parë edhe është e aplikuar. Dy, Organizata e Kombeve të Bashkuara me kohë ka miratuar Rezolutë për moduset e zgjidhjeve të kontesteve në procedura, ku, ndër të tjera, e ka përcaktuar edhe ndërmjetësimin, mediatimin. Ndryshe, ligji përgjithësisht është përgatitur relativisht mirë dhe nëpërmjet evitimit të disa defekteve: juridike, materiale, formale, do të mund të adoptohej dhe të vihej në aplikim. Pos kësaj, ju lutem, kam disa vërejtje konkrete që do të ishin në kontribut të përmirësimit të tekstit për etapën vijuese.

Ligji ka kaptinë për dispozitat e përgjithshme, por nuk ka kaptinë për dispozitat e veçanta që do të duhej ta kishte.

Me nenin 1, si kurdoherë, edhe në këtë rast, alineja e parë do të duhej të fillonte me emërtimin e plotë të Ligjit për ndërmjetësimin, e rrjedhimisht të pasonte me shkurtesën e tij Ligji,(me shkronjë të madhe)

Në nenin 1, paragrafi 2 të Ligjit, do të duhej të bëjë amendimi me tekstin kur palët në procedura sipas Ligjit, mund të disponojnë me rastin e dhënë, mund të përcaktohen për angazhimin ndërmjetësuesi. Kjo do të duhej të bëhej, ngase, veçanërisht, në çështjet

juridike-administrative, madje edhe në ato të punës, procedimi, kryesisht, aplikohet konform me parimin *jus cogens* *jus imperativum*, i cili apriori e përjashton Institutin Juridik të Ndërmjetësimit e jo sipas *jus dispositivum*, i cili dominon në çështjet juridike civile. Kjo çështje, do të thotë kështu edhe doktrinare, po edhe praktike.

Në tekstin e Ligjit përdoret shprehja ”procedurë jashtë gjyqësore”, kur i referohet ndërmjetësimit, ndërkaq në po këtë ligj, domethënë ky është projekt, por unë e përdor Ligj, pos procedurave gjyqësore theksohet edhe procedura administrative për shkak do të duhej që ajo shprehje të zëvendësohej me termin “procedura ligjore”, se nuk është fjala veç për procedurat gjyqësore, por edhe për procedurat administrative.

Me nenin 13 të Ligjit, perioda prej 90 ditëve, për kohëzgjatjen e ndërmjetësimit, do të duhej të caktohej në 30 ditë, sepse ato do të mjaftonin për një ndërmjetësim eficient dhe kjo zgjidhje do të përkonte edhe me parimin e ekonomisë në procedurë.

Neni 14 i Ligjit, adresuar bazave të ndërprerjes së ndërmjetësimit, do të duhej të amendohej edhe me faktin juridik të mundshëm të vdekjes së ndërmjetësuesit, të humbjes së zotësisë të kapacitetit veprues të ndërmjetësuesit, si dhe të privimit të ndërmjetësuesit nga liria.

Neni 14, paragrafi 5 i Ligjit, referuar fjalisë: “mund ta anulojë”, do të duhej të amendohej me shprehjen: “nuk do ta pranojë”, sepse organi në procedurë për marrëveshjen e palëve në procedurë nuk vendos *in meritum*, por ka autorizim për ta pranuar apo për mos ta pranuar marrëveshjen e tyre. Së andejmi, organi në procedurë ose e pranon ose nuk e pranon marrëveshjen e ndërmjetësuesit në procedurë, do të thotë zgjidhjen, por nuk e nulon atë ngase në atë mënyrë do të hapet mundësia për aplikim të ankesës së palës apo të palëve të interesuara, dhe në atë mënyrë, më tej e për ta zhagitur procedurën në dëmin e saj apo të tyre, të parimit të ekonomisë së procedurës madje edhe të interesit publik.

Me dispozitën e nenit 17 të Ligjit është përcaktuar se Ministria e Drejtësisë themelon komisionin e ndërmjetësimit, pasi ai Komision, sipas Ligjit në raste të caktuara, do të kishte autorizime për ndërmjetësime në procedura, ai në atë mënyrë do të mund të interferonte edhe në sferën e gjyqësorit edhe ashtu ta cenonte parimin e ndarjes dhe të kontrollimit reciprok të të tri degëve pushtetore dhe po në atë mënyrë edhe parimin e shtetit të së drejtës. Plus, ju lutem, do të krijohej edhe një administratë e panevojshme, e kushtueshme që, sipas ligjit të Parkinsonit është imanente me administratën e cila është shumë e zgjeruar për Kosovën me buxhetin tepër të cektë.

Nga neni 19 i Ligjit, duhet të fshihet alineja f) e cila i referohet dhënies së mendimeve profesionale nga Komisioni për ndërmjetësim, sepse ai organ nuk ka as nuk mund të ketë kapacitet profesional për të caktuar qëndrime apo interpretime juridike valide, madje sipas Ligjit aktiviteti i tillë e tejkalon skopjen e funksioneve themelore të Komisionit.

Nga neni 21, alineja 2, fjala: “shumicë e thjeshtë”, do të duhej të fshihej dhe të zëvendësohej me shprehjen: “shumicë relative”, ngase në terminologjinë legale njihet vetëm shprehja shumicë relative, shumicë absolute dhe shumicë e kualifikuar. Kjo është shprehje e referateve, shumica e thjeshtë- shumica.

Në alinenë 4, d) te neni 22 të Ligjit në fjalë ” me dashje” do të duhej të fshihej, ngase me te do të krijojë bazë solide për spekulime antiligjore referuar edhe delikuentit të përgjegjshëm penalisht (pavarësisht nga veprimi kulpuoz apo dolloz) që në rastet e caktuara të trajtohej favorshëm për të qenë ndërmjetësues dhe me nenin 28 të Ligjit, është përcaktuar afati prej 6 muajsh, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji për miratim të akteve nënligjore në zbatimin e po të këtij ligji.

Afati i tillë do të duhej të ishte tre muaj, ngase do të ishte suficient për hartim dhe futje në aplikim të akteve nënligjore me funksion dhe në funksion të këtij ligji. Dhe, përfundimisht, për hir të ekonomisë procedurore, jo si në mënyrën e normuar me nenin 28, anijen 2 të Ligjit, ishte dashur që me po këtë ligj të përcaktoheshin edhe rregullat e veçanta referuar aplikimit të institutit juridik të ndërmjetësimit dhe në rastet juridike të miturve, ndërkaq çështja e rregullimit të arbitrazhit do të duhej lënë në juridiksion të ligjit tregtar dhe të gjykatës tregtare.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Smaka!

Në radhë është zoti Bajram Kosumi, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndërmjetësim dhe konstaton se hartimi i këtij projektligji dhe miratimi i tij në Kuvendin e Kosovës, është i rëndësishëm, për arsye se me formimin e institucionit për ndërmjetësim, do të lehtësohet dhe do të ndihmohet mjaft shumë puna e gjykatave të vendit tonë.

Po ashtu, në anën tjetër Projektligji është i hartuar me një gjuhë të rrjedhshme dhe ka një strukturë të rregullt juridike dhe logjike, është edhe në përputhje me traditën popullore juridike shqiptare dhe deputetët tanë do të marrin pjesë në punën e komisioneve në pasurimin e ligjit me propozimet eventuale.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kosumi!

Tani e ka fjalën zoti Adem Salihaj, Lidhja Demokratike e Dardanisë

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne mendojmë se Projektligji për ndërmjetësim është një projektligj i dobishëm dhe zgjidh probleme e mosmarrëveshje të subjekteve të së drejtës që kanë të bëjnë me çështjet e pronësisë dhe çështjet tjera.

Ky ligj do t'i lirojë gjykatat nga shumë punë me të cilat janë të ngarkuara tash dhe ua mundëson atyre që t'u përkushtohen më shumë punëve të tyre të mirëfillta. Në këtë formë, pra, mund të pritet edhe ngritja e efikasitetit të gjykatat.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të subjekteve të së drejtës përmes Ligjit për ndërmjetësim, e ka anën e vet shumë pozitive, sepse zgjidh problemet me pajtimin dhe vullnetin e plotë të dy palëve dhe zgjedhja është e pranueshme për të dy palët.

Grupi Parlamentar i LDD-së, në parim e përkrah këtë projektligj, ndërsa vërejtjet tona eventuale do t'i bëjmë në procedurat e mëturtyeshme.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Salihaj!
Tani e ka fjalën, zoti Xhezair Murati, nga Grupi "7+"

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsedavajući!
Pozdrav zameniku premijera i kolegama,
Mi smo takodje razmotrili Nacrt ovog zakona koji je jedan od retkih kojeg ne poznaje Evropsko zakonodavstvo. Znači, naša tradicija, naša geneza ima iskustva sa ovakvim načinom rešavanja sporova. Mi imamo, vi svi znate, Mirovna veća, Pleqni, kako bi to još potpunije rekao. Znači, nismo neiskusni u ovoj oblasti kada je u pitanju ovakav način zakona, ali dobijanjem ovakvog zakona, mi na jedan način ozvaničujemo vanparnično pomirenje stranaka u sporu, stranaka koje se nalaze, ne znam u nekim zategnutim odnosima i tako dalje.

Veoma sam zadovoljan kada kolega Kosumi kaže da je jezik na koji je izložen ovaj Zakon, veoma razumljiv, veoma tečan, sigurno i pravno doteran. Medjutim, prevod na mom maternjem jeziku je veoma loš, tako da ima dosta nedostataka i nedoslednosti, ali u celini se shvata suština i sadržaj Nacrta ovog zakona, tako da ja ovde posebno naglašavam da ima odredjenih praznina u njemu. Pogotovo, dosta je nejasan odeljak finansijskog dela izrade ovog zakona, kako za drugu polovinu ove godine, tako i za dve naredne godine. Mislim, tu treba malo pojasniti stvari. Ima odredjenih praznina, ali od prilike sadržaj zakona, u kojem se pominju nepristrasnost, dobrovoljnost, objektivnost, čuvanje tajne, odredjivanje komisija koja će biti veoma autoritativna, posebna uloga posrednika i tako dalje, mislim da sve to garantuje da ćemo u ovom zakonu imati dopunu po jednostavljenju i ubrzanju nekih procesa koji su nam se nagomilali u sudstvu, dakle u našem pravosudju.

Iz toga, ja kažem u ime naše Parlamentarne grupe, mi podržavamo Nacrt ovog zakona i nadamo se da će daljnja procedura da neke nedostatke otkloni. Hvala Vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Murati!
Grupi Parlamentar SLS, a dëshiron të paraqitet? E ka fjalën zonja Kosara Nikolić.
Regjia, ju lutem, zonja Kosara e ka fjalën.

KOSARA NIKOLIĆ: Pozdrav svim uvaženim prisutnim poslanicima i ministrima! U ime Parlamentarne grupe SLS, mi smo razmotrili ovaj Nacrt zakona i u načelu se slažemo, ali čemo svoj doprinos dati u radu po komisijama.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani në radhë janë deputetët që janë paraqitur për fjalë.

I pari është zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryesues!

Përsëritet zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji në fjalë ka qenë në shqyrtim edhe në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe që në fillim jemi pajtuar që ky projektligj është njëri ndër projektligjet që, me të vërtetë, është i hartuar mirë. Ka norma shumë të qarta juridike, është i shkurtër dhe natyrisht që është njëri ndër projektligjet për të cilin mund të flitet me më pak gabime që ka.

Sa i përket rëndësisë, mendoj që e ngritën edhe diskutuesit edhe vetë zëvendëskryeministri, i një rëndësie të veçantë, sepse për herë të parë e rregullon, me një ligj të veçantë, një fushë të ndërmjetësimit, e cila ka qenë e rregulluar nëpër projektligje dhe ligje tjera, mirëpo, për herë të parë në mënyrë të veçantë.

Nga përmbajtja të gjitha normat apo të gjitha nenet të cilat i kemi rishqyrtuar në këtë projektligj rregullojnë në mënyrë specifike, pothuaj të gjitha rregullat e marrëdhënieve juridiko-kontestuese në fusha të ndryshme duke filluar prej asaj pronëso-ro-juridike, familjare, penale, civile e kështu me radhë. Domethënë e plotëson komplet në përmbajtje dhe e jep mundësinë që ndërmjetësuesi në të ardhmen të mos ketë probleme apo gjykata me rastin e implementimit të këtij ligji, të mos ketë probleme në implementim.

Edhe pse me këtë projektligj gjykatat, do të them, do t'i hedhin mbingarkesat që i kanë, këtu e kemi pasur, unë personalisht e kam një dilemë. A thua sa do të ndikojë, pak më parë e ngriti edhe deputeti, zoti Xhezair Murati, çështjen sa do të ndikojë në marrjen e vendimeve të drejta nga ana e gjykatësve apo e prokurorit? Këtu është një dilemë shumë e madhe, sepse çështja e ndërmjetësimit është fenomen e cila ndodh për çdo ditë edhe tani kur nuk është e rregulluar me ligj, kurse në momentin kur kjo rregullohet me ligj, unë mendoj që do të ketë ndonjë ndikim pak më tepër në gjyqësorin që të marrë vendim të drejtë.

Mirëpo, kjo është çështja e dilemës që e kemi dhe këtë dilemë ma përforcon pak çështja që ky projektligj nuk është i rregulluar edhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Është i përmendur në disa nga direktivat, mirëpo në mënyrë specifike nuk është i rregulluar edhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Kurrsesi çështje specifike kisha për ta ngritur në nenin 22, ku përmenden kushtet të cilat duhet t'i plotësojë ndërmjetësuesi. Në pikën d) thuhet se për t' i plotësuar kushtet një ndërmjetësues, duhet ta plotësojë kriterin që të mos jetë i dënuar, së paku 6 muaj me burg efektiv. Këtu e ngre një shqetësim dhe kjo çështje po përsëritet edhe në shumë ligje të cilat i kemi miratuar deri më tani dhe nuk po bëhet përjashtim për një kategori, për të cilin të gjithë e dimë për të burgosurit politikë, të cilët kanë qenë të dënuar pa fajin e tyre dhe është mirë, që , ndoshta, këtë çështje ta kemi parasysh që paragrafi apo neni të qartësohet që kjo nuk vlen për një kategori të caktuar, e kjo është kategoria e të burgosurve politikë.

Kurse krejt në fund, është mirë, mendoj që u ngrit edhe nga deputeti Sabri Hamiti, çështja e përcjelljes së projektligjeve në Kuvend. Këto dy projektligje që i kaluam më parë ishin përcjellë duke u bazuar në Kornizën Kushtetuese të Kosovës, që për mua është normal, sepse Kushtetuta ende nuk ka hyrë në fuqi dhe ajo do të hyjë në fuqi më 15 qershor. Mirëpo, shumë interesat është, tani ky projektligj thotë se hyn në fuqi kur Presidenti i Kosovës e nënshkruan, domethënë po dallon. Dy projektligjet e mëparshme ishin që të hyjnë në fuqi pasi të nënshkruhen nga PSSP-ja, tash Projektligji i tretë thotë nga Presidenti i Kosovës. Është mirë që në të ardhmen ta kemi në mënyrë unike, së paku ta rregullojmë këtë çështje.
Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni!
E kemi edhe deputetin e fundit të paraqitur Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU- Ju faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë,

Unë nuk e mbështes këtë projektligj për arsye se konsideroj se i njëjti nuk është i nevojshëm dhe do të shkaktojë shpenzimet e panevojshme. Me këtë ligj nuk do të lehtësohet puna e gjykatave, sepse kemi raste kur çështjet të iniciohen në gjykatë dhe gjykata e bënë vlerësimin se një lëndë apo një çështje kontestuese a ka nevojë apo jo të dërgohet në Komisionin ndërmjetësues, i cili për zgjidhjen e një kontesti ka afat maksimal 90 ditë, gjë që konsideroj që është një afat shumë i gjatë dhe është një prolongim i panevojshëm për zgjedhjen e një kontesti.

Puna e gjykatave, me këtë projektligj prapë konsideroj se nuk lehtësohet, puna e gjykatave do të lehtësohet me emërimin e gjyqtarëve të rinj, sepse konsideroj se është numri i vogël i gjyqtarëve në krahasim me lëndët, lëndë të cilat janë shumë të mëdha me numër në gjykata dhe shpërndarjen e lëndëve nëpër gjykatës, me zvogëlim, domethënë të numrit të lëndëve, me çka edhe arrihet efikasiteti i punës së tyre, e paraprakisht, fillimisht me stimulim, me rritjen e pagave mujore të cilat i kanë ata e jo me formimin e komisioneve ndërmjetësuese.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Novobrdaliu!
Duke qenë se ka mbaruar shqyrtimi dhe paraqitja, atëherë ka ardhur çasti që të deklarohen deputetët në parim për miratimin për miratim ose jo të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe juve të jeni gati. .

Tani ka përfunduar votimi.

Ju informoj se në sallë janë të pranishëm aktivisht 67 deputetë, nga këta 56 kanë votuar “për”, tre janë “kundër” dhe 5 kanë “abstenuar”.

Në këtë mënyrë konstatoj se ky projektligj është miratuar në parim. Ju faleminderit shumë dhe pa vonesë po shkojmë te komisionet që ngarkohen për të dhënë kontributin e mëtutjeshëm për këtë ligj. Të tilla do të jenë, natyrisht në bazë të rregullave që ju kemi thënë më përpara, do të jenë:

1. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa,
3. Komisioni për Komunitete dhe Kthim dhe
4. Komisioni për Integritet Evropian.

Siç e dini këto komisione brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë Kuvendit duhet t'i paraqesin Raportin me rekomandime.

Kojmë në pikën e fundit të kësaj seance plenare që është:

**- Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të SLS-së për
zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Punë të Jashtme**

Ju njoftoj me propozimin konkret, meqenëse deputeti Dragisha Miriq është tërhequr nga Grupi Parlamentar i SLS, kryetari i këtij grupi Parlamentar ka kërkuar nga Kuvendi, në pajtim me rregullën 48 të Rregullores së Punës zëvendësimin e deputetit Dragisha Miriq, i cili është anëtar aktual i Komisionit për Punë të Jashtme me deputeten Radmilla Vujoviq.

Na mbetet vetëm të propozojmë për këtë propozim, në qoftë se pajtoheni.

Lus regjinë si dhe juve ju lus për herë të fundit sot, që të bëheni gati. Tani!

Votimi ka përfunduar. Konstatoj se me 57 vota “për” me një votë “kundër” dhe me dy “abstenime”, është miratuar kërkesa e Grupit Parlamentar SLS.

Ju faleminderit!

Do ta kemi kënaqësinë të takohemi edhe nesër në orën 11.00.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës